



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 38 datë 07.05.2026

PËR MIRATIMIN DHE ZBATIMIN E PLANIT STRATEGJIK VENDOR PËR RININË
2026-2029 BASHKIA PËRMET

Bazuar në Ligjin Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar; Ligjit Nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; Ligjit Nr. 68/2017 «Për financat e vetqeverisjes vendore»; Ligjit Nr. 10296 datë 08.07.2010 «Për menaxhimin financiar dhe kontrollin» i ndryshuar; Ligji nr. 75/2019 "Për Rininë"; Ligji nr. 25/2022 "Për mbështetjen dhe zhvillimin e start-up-eve"; Strategjinë Kombëtare për Rininë 2022–2029; Kontrata Nr. 3537 Prot. datë 24.10.2025 midis Bashkisë Përmet dhe Shoqatës "MKEZH"; Urdhër Nr. 471 datë 07.11.2025 "Për emërimin e antarëve të Këshillit Vendor të Rinisë në Bashkinë Përmet"; Këshilli Bashkiak, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë Planin Strategjik Vendor për Rininë 2026-2029 Bashkia Përmet.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë, Turizmit dhe Rinisë dhe Drejtoria e Projekteve, Integrimit Evropian, Performancës dhe Dixhitalizimit të të Dhënave.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", (i ndryshuar).

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Aleks TANE





PLANI STRATEGJIK VENDOR PËR RININË 2026-2029 BASHKIA PËRMET



PËRMBAJTJA

I. QËLLIMI DHE METODOLOGJIA

2.1 QËLLIMIfaqe 5

2.2 METODOLOGJIA.....faqe 6

II. BASHKËRENDIMI ME POLITIKAT VENDORE, KOMBËTARE DHE EUROPIANE

III. ANALIZA E SITUATËS AKTUALE DHE GJETJET.....faqe 11

IV. VIZIONI DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIK.....faqe 29

V. ANALIZA SWOT.....faqe 37

VI. MONITORIMI DHE VLERËSIMI.....faqe 39

VII. REFERENCATfaqe 41



FJALA E KRYETARIT

Të dashur, të reja dhe të rinj të Bashkisë Përmet,

Plani Strategjik Vendor për Rininë 2026–2029 përfaqëson angazhimin tonë për ta vendosur rininë në qendër të zhvillimit të qytetit dhe të njësive tona administrative. Ky plan nuk është thjesht një dokument programatik, por një përgjigje e drejtpërdrejtë ndaj kërkesave dhe nevojave që vetë të rinjtë kanë artikuluar: më shumë mundësi për arsimim cilësor, trajnime profesionale, punësim dhe hapësira rinore ku të mësoni, të zhvilloni ide dhe të angazhoheni aktivisht.

Përmes pyetësorit dhe takimeve konsultuese me ju, u bë e qartë se të rinjtë kërkojnë të dëgjohen realisht dhe të përfshihen në proceset e vendimmarrjes, jo në mënyrë simbolike. Për këtë arsye, ky plan parashikon forcimin e mekanizmave të konsultimit, përfaqësimit dhe transparencës, si dhe bashkëpunimin e drejtpërdrejtë me të rinjtë në hartimin dhe zbatimin e nismave dhe projekteve konkrete.

Njëkohësisht, ju keni theksuar nevojën për mbështetje të talenteve të reja, për aktivitete kulturore dhe sportive më të rregullta, si dhe për krijimin e platformave që promovojnë idetë dhe iniciativat rinore. Bashkia e Përmetit angazhohet që këto kërkesa të shndërrohen në programe konkrete, të qëndrueshme, me standarde të qarta, me buxhet të dedikuar dhe me përgjegjësi të mirëpërcaktuara për zbatimin e tyre.

Si, Kryetare e Bashkisë Përmet, kam bindjen e plotë se rinia është pasuria më e madhe e komunitetit tonë. Përmes këtij plani synojmë të krijojmë kushte reale që ju të keni arsye për të qëndruar, për t'u zhvilluar dhe për të ndërtuar të ardhmen tuaj këtu, në Përmet. Ju falënderoj për zërin, mendimet dhe kontributin tuaj aktiv, pasi ky plan mban qartësisht vulën e pjesëmarrjes suaj.

KRYETAR

ALMA HOXHA



Falënderime

Në hartimin e prioriteteve të Planit Strategjik Vendor për Rininë 2026-2029 shërbyen si bazë analiza e situatës lokale dhe zëri i vetë të rinjëve, përmes tryezave të rumbullakta si dhe pyetësorit të realizuar nga Shoqata Multifunktionale për Kulturë, Edukim dhe Zhvillim (MKEZH), në kuadër të projektit *“Të Rinjtë që Sjellin Ndryshimin në Përmet”*, me mbështetje financiare të Bashkisë Përmet, në kuadër të Programit Rajonal për Demokracinë Vendore në ballkanin Perëndimor 2 (ReLOaD2).



Përmbledhje Ekzekutive

Politikat dhe dokumentet strategjike janë instrumente udhëzuese që orientojnë sektorë të veçantë të zhvillimit, në përputhje me funksionet e institucioneve dhe kuadrin ligjor. Hartimi i një dokumenti strategjik për rininë është i domosdoshëm për të drejtuar politikat publike vendore drejt përmirësimit të cilësisë së jetës së të rinjve, rritjes së mundësive të tyre dhe forcimit të rolit të tyre në zhvillimin e komunitetit. Në këtë kuadër, Plani Vendor i Rinisë 2026–2029 i Bashkisë Përmet synon të ndërtojë një qasje të integruar për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, social, mjedisor dhe kulturor duke e vendosur rininë në qendër të ndërhyrjeve vendore. Konteksti demografik e bën urgjente një politikë rinore të fokusuar dhe të matshme.

Sipas Census 2023, bashkia Përmet ka 7980 banorë nga të cilët 3,974 femra dhe 4,006 meshkuj (Tabela 1) me një rënie të popullsisë me -1.8% ndryshim mesatar vjetor (2011–2023). Struktura e moshës tregon prirje të theksuar të plakjes: 28% e popullsisë është 65+ (1,346 persona), ndërsa grupmosha 15–64 përbën 60.9% (2,929 persona) dhe 0–14 vetëm 534 persona. Kjo situatë nënkupton se mbajtja dhe fuqizimi i të rinjve në territor është faktor kyç për qëndrueshmërinë e shërbimeve, ekonomisë lokale dhe jetës komunitare. (Tabela 2).




Tabela 1. Gjinia



Tabela 2. Mosh



I. QËLLIMI I NDËRTIMIT TË PLANIT 2026-2029

Qëllimi i Planit Vendor të Rinisë 2026–2029 të bashkisë Përmet është tw përmirësojë cilësinë e jetës së të rinjve dhe të forcojë rolin e tyre si aktorë aktivë të zhvillimit lokal, përmes krijimit të mundësive reale për aftësim, punësim, përfshirje sociale dhe pjesëmarrje në vendimarrje. Plani synon të rrisë kapacitetet dhe aftësitë e të rinjëve, të nxisë aktivizimin rinor dhe të krijojë kushte të sigurta, të aksesueshme dhe gjithëpërfshirëse për një rini aktive dhe të barabartë në të gjitha fushat e jetës. Prioritet mbetet përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së jetës së të rinjve dhe forcimi i statusit të tyre, përmes rritjes së mundësive në edukim, punësim, kulturë, sport, mirëqenie sociale dhe pjesëmarrje reale në vendimarrje. Në hartimin e prioriteteve kanë shërbyer si bazë analiza e situatës lokale dhe zëri i vetë të rinjve, i mbledhur përmes pyetësorit të realizuar nga Shoqata Multifunkionale për Kulturë, Edukim dhe Zhvillim (MKEZH) në kuadër të projektit “Të Rinjtë që Sjellin Ndryshimin në Përmet” (ReLOaD2), me mbështetje financiare të Bashkisë Përmet. Në pyetësorin i cili u publikua në faqen e Bashkisë Përmet dhe në rrjetet sociale të MKEZH morën pjesë 40 të rinj, ku dominon grupmosha 15–18 vjeç (61.5%), ku shumica janë nxënës (60.5%). Shqetësimi më i madh për të rinjtë është migrimi/emigrimi (36.8%), ndjekur nga papunësia rinore dhe mungesa e tregut lokal të punës. Lidhur me masat për arsimim dhe punësim, të rinjtë kërkojnë në mënyrë të përsëritur kurse profesionale, orientim arsimor/karrier sipas nevojave të tregut lokal dhe mbështetje konkrete për punësimin (praktika, ura komunikimi me bizneset lokale, etj). Përfshirja në vendimarrje vlerësohet kryesisht si e pamjaftueshme: vetëm një pjesë shumë e vogël deklaroi “po”, ndërsa shumica shprehen “jo” ose “pjesërisht”, duke kërkuar *takime të drejtëpërdrejta me bashkinë*, forcimin e *Këshillit Rinor Vendor*, *konsultime të rregullta dhe transparencë*. Në fushën e hapësirave dhe aktiviteteve, kërkesa më e fortë lidhet me krijimin e një platforme për promovimin e ideve rinore dhe mbështetje për talentet e reja, si dhe një kalendar aktiviteteve cilësore, jo sporadike. Përsa i përket informimit, të rinjtë preferojnë si kanale më efektive takimet fizike, rrjetet sociale dhe shkollat/institucionet arsimore, duke sugjeruar nevojën për një model komunikimi të kombinuar dhe të rregullt.

Pesë shtyllat kryesore mbi të cilat bazohet Plani Vendor i Rinisë 2026-2029 në bashkinë Përmet janë në harmoni me orientimet strategjike kombëtare dhe evropiane si dhe me nevojat e evidentuara në nivel lokal, të përkthyer në objektiva, masa dhe indikatorë konkretë si më poshtë:

1. Arsimi cilësor dhe gjithëpërfshirës-synon garantimin e aksesueshmërisë dhe mundësive të barabarta për të gjithë nxënësit, pavarësisht statusit social, ekonomik apo aftësive të tyre. Fokusi vendoset në sigurimin e mjeteve praktike që rrisin cilësinë e proceseve mësimore, si dhe nxitjen e aktiviteteve dhe shkëmbimeve mes shkollave që rrisin motivimin, përfshirjen dhe prespektivën e të rinjve në territor.

2. Punësimi dhe sipërmarrja rinore- synon ofrimin e mikro granteve, mentorimit, këshillimit dhe mbështetjes teknike për ide biznesi rinore, me fokus të veçantë përfshirjen e të rinjëve edhe nga zonat rurale, në bashkëpunim me donatorë kombëtarë dhe ndërkombëtarë, me synim krijimin e mundësive të barabarta për sipërmarrje dhe zhvillim ekonomik lokal dhe minimizimin e migrimit/emigrimit të të rinjëve.



3. **Pjesëmarrja dhe përfaqësimi rinor në vendimarrjen lokale**-përmes mekanizmave të qëndrueshëm të konsultimit (takime periodike, konsultime publike të strukturuar, platforma sugjerimesh), si dhe forcimit funksional të Këshillit Rinor Vendor me rol këshillues, plane pune dhe ndikim real në politikat vendore.

4. **Arti, sporti, kultura dhe hapësirat rinore**-duke garantuar hapësira dhe aktivitete cilësore që mbështesin talentet, krijmtarinë dhe mirëqenien sociale, me kalendar të rregullt dhe akses për të rinjtë si në zonat urbane ashtu edhe në ato rurale.

5. **Mirëqënie sociale, shëndeti dhe shërbimet publike për të rinjtë**- synon forcimin e shërbimeve sociale dhe shëndetësore për të rinjtë, duke rritur aksesin në informacion, mbështetjen psiko-sociale dhe mjedise të sigurt. Fokus i veçantë i jepet përfshirjes së të rinjve nga zonat rurale, të rinjve me aftësi ndryshe dhe atyre nga shtresat e marginalizuara dhe komunitetet. Plan i Vendor i Rinisë 2026- 2029 i bashkisë Përmet ndërtohet mbi një logjikë të qartë: zbutja e faktorëve që shtyjnë emigrimin krijimi i mundësive konkrete për aftësim dhe punësim, forcimi i pjesëmarrjes reale në vendimarrje dhe ndërtimi i një infrastrukture komunitare ku të rinjtë ndihen të përfshirë, të vlerësuar dhe me prespektivë në nivel lokal. Ky Plan e trajton rininë jo vetëm si përfitues të shërbimeve, por si aktor kyç të zhvillimit të Përmetit.

Plan i synon të; shndërrojë prioritetet dhe kërkesat e të rinjve në programe dhe ndërhyrje konkrete, me përgjegjësi të qarta, burime të planifikuara dhe indikatorë monitorimi, duke garantuar një qasje të qëndrueshme dhe të matshme për zhvillimin e rinisë në bashkinë Përmet gjatë periudhës 2026-2029.

II. METODOLOGJIA

Hartimi i Planit Strategjik Vendor për Rininë (PSVR) 2026-2029 të Bashkisë Përmet u mbështet në një **qasje metodologjike mikse** (cilësore dhe sasiore), duke kombinuar burime parësore (të dhëna të mbledhura drejtpërdrejt nga të rinjtë dhe aktorë vendorë) me burime dytësore (kuadër ligjor, strategji kombëtare/vendore dhe dokumente planifikuese ekzistuese). Kjo qasje u zgjodh për të siguruar një pasqyrë sa më të plotë mbi situatën e rinisë në territor, për të evidentuar prioritetet reale të të rinjve dhe për të orientuar objektivat e planit drejt ndërhyrjeve të zbatueshme në nivel vendor.

2.1 Burimet parësore: pyetësi dhe konsultimet me të rinjtë

Instrumenti kryesor i mbledhjes së të dhënave sasiore ishte **pyetësi online**, i hartuar për të matur perceptimin e të rinjve mbi sfidat kryesore, nevojat dhe propozimet konkrete që duhet të adresohen në PSVR 2026–2029. Pyetësi u përbë nga **14 pyetje** dhe u plotësua nga **40 të rinj dhe të reja**. Struktura e pyetësit u organizua në disa blloqe tematike që mbulojnë dimensionet kryesore të politikave rinore në bashki:



- **Profil demografik dhe status** (mosha, gjinia, statusi aktual: mosha, gjinia, statusi aktual: nxënës/student/i punësuar etj.), për të kuptuar se cilat grupe përfaqësohen dhe si lidhen nevojat me statusin arsimor/punësimin.
- **Sfidat kryesore**, ku pjesëmarrësit identifikuan problematikat më dominuese (me mundësi zgjedhjeje deri në 3 alternativa), si: emigrimi, tregu i kufizuar i punës, papunësia rinore, mungesa e hapësirave rinore, mungesa e aktiviteteve kulturore e sportive, informimi i pamjaftueshëm dhe çështje të tjera të infrastrukturës/mbështetjes sociale.
- **Arsimi, punësimi dhe aftësitë**, ku u testua masat që të rinjtë i konsiderojnë të nevojshme për t'u përfshirë në plan (p.sh, kurse profesionale, orientim karriere sipas tregut lokal, mbështetje për punësimin, përmirësim kushtesh dhe motivimi për të rinjtë e punësuar, si dhe mbështetje për kategori në nevojë).
- **Pjesëmarrja dhe vendimarrja**, ku u mat perceptimi mbi nivelin e përfshirjes së të rinjve në vendimarrjen lokale, si dhe format që duhet të forcohen (konsultime publike, anketa, grupe mendimi kritik, platforma online, takime të drejtpërdrejta me bashkinë, Këshilli Rinor Vendor). Një pyetje e hapur u përdor për të identifikuar qartë të drejtat që të rinjtë kërkojnë të garantohet më fort, si: e drejta për t'u dëgjuar realisht, transparencë dhe informim, përfaqësim në struktura vendore dhe pjesëmarrje në mbledhje/ procese që i prekin drejtpërdrejt.
- **Hapësira, aktivitete dhe talente**, ku u identifikuan boshllëqe në shërbime dhe infrastrukturë rinore (hapësira rekreative, aktivitete kulturore/sportive, mbështetje për talentet dhe platforma për promovimin e ideve rinore).
- Informimi dhe komunikimi, ku u mat niveli i informimit mbi mundësitë që ofron bashkia dhe u identifikuan kanalet më efektive për komunikim (rrjete sociale, takime fizike, shkollat/institucionet arsimore, platforma arsimore, platforma online të bashkisë).
- **Pyetje të hapura për sugjerime dhe prioritetet buxhetore**, të cilat prodhuan rekomandime konkrete për përmirësimin e jetës rinore, për orientimin e fondeve (arsim, punësim, hapësira rinore, sport/kulturë, sipërmarrje rinore, vullnetarizëm dhe angazhim qytetar), si dhe për cilësinë/frekuencën e aktiviteteve rinore (kulturore, sportive, edukative dhe sociale).

Përveç pyetësorit, u realizuan dhe 6 takime, pyetësor online, dhe diskutime konsultuese me të rinjtë, (tryeza/ biseda të drejtpërdrejta), të cilat shërbyen për: (i) interpretimin më të thellë të gjetjeve sasiore (ii) verifikimin e problematikave kryesore në terren dhe (iii) formulimin e propozimeve të realizueshme në programet e planit. Konsultimet ndihmuan që PSVR të mos mbetet vetëm në nivel diagnoze, por të përkthehet në ndërhyrje konkrete dhe të prioritizuara.

2.2 Burimet dytësore: kuadri ligjor dhe dokumentet strategjike

PSVR 2026–2029 u hartua në përputhje me kuadrin ligjor që rregullon rolin dhe kompetencat e Njësisë të Qeverisjes Vendore (NJQV) në fushën e rinisë, veçanërisht Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe Ligjin nr. 75/2019 “Për Rininë”, I ndryshuar me ligjin Nr.24/2025



“Për Rininë”, Ligji 45/2016 “Për vullnetarizmin” shqyrtimi i kuadrit ligjor ishte i domosdoshëm për të siguruar që objektivat, masat dhe mekanizmat e zbatimit të jenë të ligjshëm, të realizueshëm dhe të harmonizuar me përgjegjësitë vendore (përfshirë rolin e bashkisë në krijimin e mekanizmave të pjesëmarrjes rinore, financimin e hapësirave rinore, ofrimin e veprimtarive dhe mbledhjen/raportimin e të dhënave).

Paralelisht, janë referuar dokumente strategjike kombëtare dhe ndërkombëtare që orientojnë politikat rinore, me qëllim krijimin e një kuadri koherent me standardet e integritetit dhe zhvillimit. Një element i rëndësishëm i burimeve dytësore ishte edhe shqyrtimi i dokumenteve vendore të mëparshme, veçanërisht Plani Lokal i Veprimit për Rininë 2021–2023, për të vlerësuar: çfarë është planifikuar, çfarë është realizuar, cilat masa kanë pasur efekt, cilat boshllëqe mbeten dhe cilat nevoja janë shfaqur ose janë forcuar gjatë viteve të fundit. Kjo analizë shërbeu si bazë për të vendosur objektiva më realiste, të matshme dhe të lidhura me kapacitetet dhe burimet vendore.

2.3 Përpunimi i të dhënave dhe përgatitja e planit të zbatimit.

Të dhënat nga pyetësi u përpunuan në formë përmbledhëse (përqindje dhe shpërndarje sipas temave kryesore), ndërsa përgjigjet e hapura dhe diskutimet konsultuese u analizuan cilësisht për të nxjerrë temat dominuese, kërkesat e përsëritura dhe rekomandimet konkrete. Në përfundim, u hartua drafti i PSVR-së i strukturuar në qëllime, objektiva dhe masa/programe, të shoqëruara me indikatorë matës. Vëmendje e veçantë iu kushtua ndërtimit të sistemit të monitorimit dhe vlerësimit: përcaktimit të strukturave përgjegjëse, targeteve, burimeve të të dhënave dhe frekuencës së raportimit për secilin indikator, me qëllim që zbatimi i planit të jetë i gjurmueshëm, transparent dhe i orientuar nga rezultatet. Matrica/formati i raportimit parashikohet të përfshihet si bashkëlidhje në kapitullin përkatës të dokumentit.

III. BASHKËRENDIMI ME KUADRIN LIGJOR, DOKUMENTET STRATEGJIKË DHE POLITIKAT KOMBËTARE, VENDORE DHE EUROPIANE

Plani Strategjik Vendor për Rininë (PSVR) 2026–2029 i bashkisë Përmet, harmonizohet me kuadrin ligjor dhe dokumentet strategjike kombëtare e ndërkombëtare, me qëllim që masat e propozuara të jenë: (1) të ligjshme dhe të zbatueshme në nivel vendor, (2) të koordinuara me politikat qendrore dhe prioritetet e integritetit evropian, dhe (3) të orientuara drejt nevojave reale të të rinjve të Përmetit, të evidentuara përmes konsultimeve dhe pyetësorit. Në këtë kuadër, Bashkia angazhohet për koordinim më efikas me institucionet qendrore, organizatat rinore/organizatat për të rinjtë, institucionet arsimore, strukturat e punësimit dhe aktorët lokalë (biznes, shoqëri civile), duke synuar sinergji dhe përdorim optimal të burimeve.

3.1 Kuadri ligjor dhe institucional në mbështetje të sektorit të rinisë nga NJVV-të

Ligji nr 75/2019 “Për Rininë”, i ndryshuar me ligjin nr. 24/2025, datë 17.3.2025



Ligji “Për Rininë”, është baza kryesore ligjore që orienton hartimin dhe zbatimin e politikave rinore edhe në nivel vendor. Ai synon mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të të rinjve, krijimin e kushteve për aktivizim, pjesëmarrje dhe mbështetje, si dhe përcaktimin e kompetencave të institucioneve qendrore e vendore. Referuar ligjit, “të rinj” konsiderohen personat **15–29 vjeç**.

Për, bashkinë Përmet, ligji është referencë e drejtpërdrejtë për: (a) garantimin e pjesëmarrjes reale të të rinjve në vendimmarrje, (b) zhvillimin e edukimit joformal dhe vullnetarizmit, (c) mbështetjen për infrastrukturën rinore dhe hapësirat e sigurta, si dhe (d) mbledhjen e të dhënave dhe raportimin periodik mbi situatën e të rinjve në territor.

Ligji ofron gjithashtu risi në lidhje me grupet joformale rinore, punonjësin rinor dhe punën rinore.

Ligji 139/2025 “Per vetqeverisjen vendore” mbi rolin e NJVV-ve, bashkia Përmet do të jetë përgjegjëse për:

- pasqyrimin dhe respektimin e të drejtave të të rinjve në politikatt dhe buxhetet vendore;
- krijimin dhe/ose funksionalizimin e Këshillit Vendor të Rinisë dhe mekanizmave të konsultimit;
- organizimin dhe koordinimin e veprimtarive rinore që lidhen me fuqizimin, mirëqenien dhe zhvillimin e të rinjve;
- nxitjen e vullnetarizmit dhe edukimit joformal;
- financim dhe zhvillimin e infrastrukturës/hapësirave rinore të sigurta;
- krijimin e kapaciteteve administrative për çështjet e rinisë;
- planifikimin e fondeve për programe dhe projekte rinore;.

Ligji nr 25/2022 “Për mbështetjen dhe zhvillimin e start-up-eve”

Ligji krijon një kuadër rregullator dhe institucional për nxitjen e inovacionit, sipërmarrjes së re dhe zhvillimit ekonomik. Në kontekstin e PSVR-së së bashkisë Përmet, ai shërben si bazë për ndërhyrje që lidhen me:

- rritjen e aftësive sipërmarrëse dhe digjitale të të rinjve;
- mbështetjen e ideve inovative (veçanërisht të të rinjve dhe garve të reja);
- lidhjen e të rinjve me ekosostemin mbështetës (trajnime, mentorim, programe, rrjete bashkëpunimi)

LIGJ Nr. 94/2025 për Vullnetarizmin ka për qëllim krijimin e një kuadri rregullator e institucional të favorshëm për kryerjen e vullnetarizmit dhe nxitjen e pjesëmarrjes së individëve në vullnetarizëm, zhvillimin e vlerave njerëzore dhe solidaritetin shoqëror. Ligji i ri për vullnetarizmin mbetet një nga pikat më të rëndësishme për tu përmendur në plan sepse ofron themelimin e institutive të reja juridike në këtë fushë – llojin e vullnetarizmit/ofruesin / kontrata/ njohja e vullnetarizmit etj.



3.2 Politika dhe strategji në nivel lokal/kombëtar me të cilat harmonizohet PSVR i Bashkisë Përmet

Plani i Kujdesit Social i Bashkisë Përmet 2024–2027

(miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr. 79, datë 23.10.2024)

PSVR 2026–2029 harmonizohet me Planin e Kujdesit Social 2024–2027 duke forcuar masat që lidhen drejtpërdrejt me mirëqenien e të rinjve, aksesin në shërbime dhe përfshirjen sociale, veçanërisht për të rinjtë në zonat rurale, të rinjtë me aftësi ndryshe dhe ata nga shtresa/komunitete të marginalizuara. Në këtë linjë, PSVR orienton masat drejt: a) rritjes së aksesit të të rinjve në shërbime mbështetëse dhe ndërhyrje komunitare (informim, orientim, referim); b) forcimit të mbështetjes psiko-sociale dhe mekanizmave të parandalimit (shëndet mendor, shëndet seksual, varësi, dhunë/risqe sociale); c) zgjerimit të shtrirjes territoriale të shërbimeve dhe aktiviteteve për të rinjtë edhe në 4 njësitë administrative; d) nxitjes së vullnetarizmit dhe qytetarisë aktive si formë përfshirjeje dhe kontributi në komunitet; si dhe bashkëpunimit ndërsektorial me strukturat vendore, shkollat, shërbimet shëndetësore dhe aktorët lokalë për zbatim më efektiv të shërbimeve..

PSVR 2026–2029 harmonizohet me prioritetet e politikave kombëtare, veçanërisht me:

- **Strategjinë Kombëtare për Rininë 2022–2029**, e miratuar me VKM nr. 692, datë 26.10.2022, e cila fokusohet te: (1) pjesëmarrja dhe fuqizimi, (2) aftësitë/novacioni dhe lidhja me tregun e punës, (3) mirëqenia, siguria dhe përfshirja e të rinjve, sidomos atyre vulnerabël.
- **Strategjinë Kombëtare për Arsimin 2021–2026**, e cila mbështet modernizimin e mjediseve mësimore, TIK-un, aktivitetet pas mësimit dhe masa që lidhen me rritjen e cilësisë dhe aksesit.
- **Agjendën Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021–2026**, që thekson mekanizmat vendorë, pjesëmarrjen kuptimplotë, shërbimet kulturore/argëtuese dhe përdorimin e platformave digjitale për angazhimin e fëmijëve e të rinjve.
- **Planin Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2021–2025**, i cili kërkon masa lokale për akses në shërbime, programe mbështetëse në arsim dhe lehtësim të barrierave socio-ekonomike—elementë që PSVR i Përmetit i reflekton në parimin e gjithëpërfshirjes dhe masat për barazi mundësish.

3.3 Strategji në nivel ndërkombëtar që harmonizojnë PSVR-në e Bashkisë Përmet

Në linjë me standardet dhe praktikrat europiane/ndërkombëtare, PSVR i Bashkisë Përmet bashkërendohet me:



- **UN Youth 2030 (Strategjia e OKB-së për Rininë)**, që synon fuqizimin e të rinjve si agentë ndryshimi dhe lidhjen e politikave me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (p.sh. shëndet/mirëqenie, arsim cilësor, barazi gjinore, punë dinjitoze, veprim klimatik).
- **Strategjinë Europiane për të Rinjtë 2019–2027 dhe “11 Youth Goals”**, që orientojnë vendimmarrjen drejt përfshirjes, barazisë, mirëqenies, të mësuarit cilësor, punësimit cilësor, hapësirës dhe pjesëmarrjes për të gjithë.
- **Youth Sector Strategy 2030 e Këshillit të Evropës**, që forcon demokracinë, të drejtat e njeriut dhe shtetin e së drejtës përmes angazhimit dhe pjesëmarrjes së të rinjve.
- **Agjendën e BE-së për Ballkanin Perëndimor mbi inovacionin, kërkimin, arsimin, kulturën, rininë dhe sportin**, që mbështet transformimin digjital, Agjendën e Gjelbër dhe rritjen e cilësisë së aftësive/arsimimit profesional-drejtime që PSVR i Përmetit i lidh me prioritetet për kurse, aftësi praktike, platforma rinore dhe nisma komunitare

IV- ANALIZA E TE DHËNAVE DHE GJETJET

Prioritetet e të rinjve dhe të rejave - Bashkia Përmet

Ky kapitull paraqet profilin demografik dhe social të pjesëmarrësve në pyetësor, si bazë për interpretimin e prioriteteve rinore në PSVR 2026–2029. Të dhënat përmbledhëse janë strukturuar në tre tabela, sipas moshës, gjinisë dhe statusit aktual.

Pyetja 1. Moshë e pjesëmarrësve

Në pyetësor morën pjesë 40 të rinj. Grupi dominues ishte ai i moshës 15–18 vjeç, që përbën 62.5% të pjesëmarrësve (25 persona). Grupi 25–29 vjeç përfaqësohet nga 30% (12 persona), ndërsa grupmosha 19–24 vjeç nga 7.5% (3 persona). Kjo tregon një përfaqësim më të lartë të adoleshentëve dhe të rinjve në fazën e hershme të formimit arsimor dhe orientimit profesional, Tabela 3.




Tabela 3. Moshë e pjesëmarrësve

Pyetja 2. Gjinia e pjesëmarrësve

Nga 40 pjesëmarrës, 39 iu përgjigjën pyetjes mbi gjininë. Prej tyre, 66.7% (26 persona) janë femra dhe 33.3% (13 persona) meshkuj. Ky raport tregon një pjesëmarrje më të lartë të vajzave

në procesin konsultues, duke reflektuar interes të shtuar të tyre për çështjet e rinisë dhe vendimmarrjen lokale, Tabela 4.




Tabela 4. Gjinia e pjesëmarrësve

Pyetja 3: Statusi aktual i pjesëmarrësve

Nga 39 përgjigje të vlefshme, 61.5% e pjesëmarrësve (24 persona) janë nxënës, 33.3% (13 persona) janë të punësuar dhe 5.1% (2 persona) janë studentë. Në pyetësor nuk u evidentua pjesëmarrje nga të rinj të papunë, emigrantë apo në proces emigrimi. Kjo strukturë tregon se zëri kryesor në këtë proces vjen nga të rinjtë që janë ende në arsim ose të sapo përfshirë në tregun e punës, Tabela 5.




Tabela 5. Statusi aktual i pjesëmarrësve

Në tërësi, profili i pjesëmarrësve tregon se prioritetet e identifikuara në këtë plan pasqyrojnë kryesisht nevojat dhe pritshmëritë e të rinjve në fazat e hershme të edukimit dhe integrimit profesional, çka duhet të merret parasysh në projektimin e masave për arsim, aftësim, punësim dhe pjesëmarrje aktive në jetën publike.



Pyetja 4: Sfidat kryesore të të rinjve në Bashkinë Përmet

Pyetjes, “Cilat mendoni se janë çështjet me të cilat përballet rinia në bashkinë Përmet?”, ku të rinjtë kishin mundësi zgjedhjeje deri në 3 alternativa), nga 40 pjesëmarrës u përgjigjën 39 persona. Rezultatet treguan, se sfida më e theksuar është emigrimi i të rinjve, i zgjedhur nga 15 persona (38.5%), duke reflektuar një shqetësim të fortë për largimin e vazhdueshëm të rinisë nga Përmeti dhe zonat përreth. Në vend të dytë renditet papunësia rinore, e përzgjedhur nga 9 persona (23.1%), ndërsa mungesa e tregut të punës u evidentua nga 7 persona (17.9%), çka tregon se problemet ekonomike dhe të punësimit mbeten faktorë shtytës të migrimit. Ndërkohë, problematika të lidhura me jetën komunitare dhe zhvillimin social dalin më pak të theksuara në zgjedhje: mungesa e aktiviteteve kulturore dhe sportive u përzgjedh nga 3 persona (7.7%), ndërsa mungesa e hapësirave rinore nga 2 persona (5.1%). Përqindje më të ulëta shfaqen për faktorë të tjerë: vështirësitë ekonomike në familje (1 person; 2.6%), mungesa e informimit (1 person; 2.6%) dhe infrastruktura shkollore (1 person; 2.6%), **Tabela 6.**



Tabela 6. Sfidat kryesore të të rinjve në Bashkinë Përmet

Gjetjet sugjerojnë se sfidat kryesore janë strukturore dhe ekonomike (migrimi, papunësia, mungesa e tregut të punës), ndërsa çështjet e hapësirave dhe aktiviteteve rinore dalin si nevojat plotësuese, por gjithsesi të pranishme.

Pyetja 5. Masat e kërkuara për arsimim, punësim dhe aftësi

Lidhur me; “Cilat masa mendoni se duhet të përfshihen në Planin Vendor për Rininë lidhur me arsimimin dhe punësimin?”, nga 40 pjesëmarrës u përgjigjën 38 persona. Gjetjet tregojnë se prioriteti kryesor për të rinjtë është aftësimi praktik dhe profesional, ku “Hapja e kurseve profesionale” u përzgjedh nga 12 persona (31.6%). Pas kësaj, “Orientimi për arsimim sipas nevojave të tregut lokal të punës” u konsiderua masë kyçe nga 11 persona (28.9%), duke treguar kërkesë për lidhje më të fortë mes arsimit dhe punësimit real në territor.

Gjithashtu, “Mbështetja për punësimin e të rinjve” u kërkuar nga 8 persona (21.1%), çka nënkupton nevojë për programe konkrete punësimi (praktika, ndërmjetësim, mbështetje për hyrje në treg). Më pas, një pjesë më e vogël thekson rëndësinë e cilësisë së punës për të rinjtë që janë tashmë të punësuar: “Rritje motivimi dhe përmirësim kushtesh për të rinjtë e punësuar” u zgjedh



nga 3 persona (7.9%). Ndërkohë, “Mbështetje për të rinjtë nga shtresat me ndihmë ekonomike” u përzgjedh nga 2 persona (5.3%), dhe opsioni “Tjetër” (pa specifikim të mëtejshëm) u shënuar gjithashtu nga 2 persona (5.3%), Tabela 7.




Tabela 7: Masat e kërkuara për arsimim, punësim dhe aftësi

Konstatohet se, prioritetet e të rinjve fokusohen te krijimi i aftësive të kërkuara nga tregu, orientimi i qartë profesional dhe mbështetja direkte për punësim, si masa që adresojnë edhe shkakun kryesor të identifikuar më herët: emigrimin.

Pyetja 6: Pjesëmarrja dhe vendimmarrja lokale

Pyetje se: A mendoni se të rinjtë përfshihen mjaftueshëm në vendimmarrjen lokale? nga 40 pjesëmarrës u përgjigjën 39 të rinj/reja çka tregojnë interes dhe gatishmëri për të dhënë opinion. Gjetja kryesore është se perceptimi dominues nuk është as “po” as “jo”, por “pjesërisht”: 23 persona (59%) vlerësojnë se të rinjtë përfshihen vetëm deri diku. Kjo do të thotë se ka forma kontakti ose përfshirjeje që ekzistojnë, por ato nuk janë të mjaftueshme, jo të rregullta, ose jo me ndikim real në vendimmarrje. Në të njëjtën kohë, një pjesë e konsiderueshme shpreh një qëndrim më kritik: 15 persona (38%) deklarojnë se të rinjtë nuk përfshihen. Kjo përqindje e lartë tregon se; shumë të rinj e perceptojnë procesin e vendimmarrjes si të largët, me hapësira të kufizuara pjesëmarrjeje ose me mungesë kanalesh të qarta për kontribut. Ndërsa vetëm 1 person (3%) përgjigjet “Po”, duke treguar se përfshirja e plotë shihet si përjashtim dhe jo si realitet i zakonshëm. Të dhënat nxjerrin në pah se shumica e të rinjve e shohin përfshirjen si të pjesshme, çka e vendos prioritetin te forcimi i mekanizmave të pjesëmarrjes (konsultime më të rregullta, takime të hapura me bashkinë, struktura rinore funksionale) dhe te rritja e ndjesisë se kontributi i tyre dëgjohet dhe reflektohet në vendime konkrete. Tabela 8




Tabela 8: Pjesëmarrja dhe vendimarrja lokale

Pyetja 7. Format e pjesëmarrjes

Pyetjes se, “Cilat janë format e pjesëmarrjes që do të dëshironit të forcohen”, ku të rinjtë kishin 3 (tre) alternativa për të zgjedhur, nga 40 pjesëmarrës u përgjigjën 38 persona, çka tregon interes të lartë për mënyrën se si mund të rritet angazhimi rinor në proceset lokale. Opsioni më i kërkuar rezultoi të jenë takimet e drejtpërdrejta me bashkinë, të përzgjedhura nga 15 persona (39.5%). Kjo tregon qartë se të rinjtë kërkojnë komunikim të hapur, fizik dhe të rregullt, ku të kenë mundësi të shprehen ballë për ballë dhe të marrin përgjigje konkrete për çështjet që i prekin. Këshilli Rinor Vendor, renditet i dyti i sugjeruar nga 8 persona (21.1%), duke reflektuar nevojën për një strukturë të qëndrueshme përfaqësimi, ku rinia të mos konsultohet vetëm rastësisht, por të ketë një kanal institucional që e lidh me vendimarrjen. Konsultimet publike u përzgjedhën nga 5 persona (13.2%), çka tregon se një pjesë e të rinjve e sheh si të rëndësishme edhe pjesëmarrjen në formatet formale të konsultimit, por kjo nuk është forma më e preferuar krahasuar me komunikimin direkt. Format më të lehta dhe më fleksibël si pyetësorët dhe anketat u përmendën nga 4 persona (10.5%), ndërsa grupet e mendimit kritik dhe platformat online për sugjerime u përzgjedhën respektivisht nga 3 persona (7.9%) secila. Këto të dhëna sugjerojnë se, edhe pse kanalet digjitale dhe formatet konsultuese kanë vlerë, për të rinjtë ato shihen më shumë si mjete mbështetëse, jo si forma kryesore e pjesëmarrjes, Tabela 9.






Tabela 9: Format e pjesëmarrjes

Rezultatet tregojnë se, të rinjtë në bashkinë Përmet kërkojnë mbi të gjitha pjesëmarrje reale dhe të dukshme, ku bashkia të jetë e pranishme dhe e aksesueshme, dhe ku zëri i tyre të dëgjohet drejtpërdrejt. Prioriteti i parë duhet të jetë institucionalizimi i takimeve periodike me të rinjtë dhe funksionalizimi i Këshillit Rinor Vendor, ndërsa konsultimet publike, pyetësorët dhe platformat online duhet të përdoren si mekanizma plotësues për të zgjeruar përfshirjen dhe për të mbledhur sugjerime më të strukturuar.

Pyetja 8: Të drejtat e të rinjve për pjesëmarrje në vendimmarrje që duhen garantuar më fort

Pyetjes se: “Cilat janë të drejtat e të rinjve për pjesëmarrje në vendimmarrje që duhen garantuar më shumë”, nga 40 pjesëmarrës në pyetësor, vetëm 20 të rinj dhe të reja (50%), dhanë përgjigje të hapura, çka tregon se pjesëmarrja reflektuese mbetet ende e kufizuar, por njëkohësisht ofron një pasqyrë të qartë të shqetësimeve reale të atyre që zgjedhin të shprehen. Përgjigjet tregojnë se të rinjtë e Bashkisë Përmet e perceptojnë pjesëmarrjen në vendimmarrje si formale dhe jo efektive, duke theksuar se zëri i tyre nuk dëgjohet mjaftueshëm dhe se përfshirja aktuale nuk prodhon ndikim real në vendimet lokale. Gjetja kryesore është se e drejta për t’u dëgjuar shihet si e drejta më e cënuar dhe më pak e garantuar. Një pjesë e konsiderueshme e të rinjve kërkojnë pjesëmarrje pa përjashtim, duke theksuar se çdo i ri duhet të ketë mundësi të marrë pjesë në aktivitete, mbledhje, kurse dhe iniciativa që zhvillojnë aftësitë dhe potencialin e tyre. Kjo tregon nevojën për mekanizma gjithëpërfshirës dhe të hapur, që nuk kufizohen vetëm në grupe të vogla apo struktura formale. Përgjigjet, theksojnë rëndësinë e përfaqësimit të të rinjve në strukturat vendimmarrëse, si Këshilli Rinor Vendor dhe mbledhjet e Këshillit Bashkiak, jo vetëm si dëgjues, por me mundësi reale për të dhënë mendim dhe për të ndikuar në vendime që lidhen drejtpërdrejt me rininë. Kjo kërkesë shoqërohet me nevojën për transparencë, informim të qartë dhe komunikim të drejtpërdrejtë me bashkinë. Një element i rëndësishëm i gjetjeve është lidhja që të rinjtë bëjnë midis pjesëmarrjes dhe çështjeve ekonomike, veçanërisht punësimit, të ardhurave dhe trajnimit. Për ta, pjesëmarrja në vendimmarrje nuk është vetëm një e drejtë demokratike, por edhe një mjet për të përmirësuar kushtet e jetesës dhe perspektivat për të ardhmen. Në tërësi, përgjigjet e dhëna tregojnë se të rinjtë kërkojnë një kalim nga pjesëmarrja simbolike drejt pjesëmarrjes reale, ku mendimi i tyre të merret seriozisht dhe të reflektohet në politikat dhe vendimet vendore, Tabela 10.



E DREJTA E TE RINJEVE PER VENDIMARRJE

"Duhet të jenë më të angazhuar dhe bashkia të ofrojë më shumë..."	"E drejta për përfaqësim në strukturat vendimarrëse."	"Dhënie mendimesh."	"Të rinjtë duhet të kenë të drejtën për të marrë..."	"Komoditeti, marrja e informacionit,..."	"E drejta për informim dhe..."
		"Të rinjtë duhet të pyeten dhe të jenë në qendër të..."	"E drejta për t'u organizuar dhe për..."	"Mbështetje për punësim..."	"Pjesëmarrja nuk duhet..."
"Punësimi dhe të ardhurat."	"E drejta për t'u dëgjuar realisht, jo vetëm formalisht."	"Pjesëmarrja në mbledhjet e Këshillit Bashkiak për..."	"E drejta për të shprehur..."	"Duhet të dëgjohet..."	"Të rinjtë..."
				"Të dëgjohet..."	"D..."
				"Bash..."	"C..."

Tabela 10. Të drejtat e të rinjve për pjesëmarrje në vendimarrje që duhen garantuar më fort

Përgjigjet e të rinjve (të renditura, sipas shprehjes së tyre)

1. "Çdo i ri pa përjashtim të marrë pjesë në aktivitete, mbledhje apo kurse që zhvillojnë diapazonin e tyre."
2. "Duhet të garantohet më fort e drejta e të rinjve për t'u dëgjuar dhe për t'u përfshirë realisht në proceset vendimarrëse që lidhen me arsimin, punësimin dhe aktivitetet rinore."
3. "Të rinjtë duhet të kenë përfaqësues në këshilla rinore dhe struktura vendore dhe të konsultohen për projektet që i prekin drejtpërdrejt."
4. "Bashkia duhet t'i integrojë të rinjtë përmes pyetësorëve, mbledhjeve dhe programeve."
5. "Të dëgjohet fjala e të rinjve."
6. "Duhet të dëgjohet zëri i të rinjve sepse nuk dëgjohet."
7. "Pjesëmarrja nuk duhet të jetë simbolike, por një pjesë reale e demokracisë."
8. "Mbështetje për punësimin rinor."
9. "E drejta për të shprehur opinionin dhe idetë."
10. "E drejta për t'u organizuar dhe për të marrë pjesë në iniciativa rinore."
11. "E drejta për informim dhe transparencë."
12. "Komoditeti, marrja e informacionit, liria e një aktiviteti vetëkrijues dhe realizimi i tij."
13. "Të rinjtë duhet të kenë të drejtën për të marrë pjesë në vendimarrje që i prek drejtpërdrejt."
14. "Pjesëmarrja në mbledhjet e Këshillit Bashkiak për çështjet e rinisë."
15. "Të rinjtë duhet të pyeten dhe të jenë në qendër të procesit kur merren masa për ta."
16. "Dhënie mendimesh."
17. "E drejta për t'u dëgjuar realisht, jo vetëm formalisht."
18. "E drejta për përfaqësim në strukturat vendimarrëse."
19. "Punësimi dhe të ardhurat."
20. "Duhet të jenë më të angazhuar dhe bashkia të ofrojë më shumë vende pune."

Pyetja 9: Mungesa e hapësirave rinore

Pyetjes lidhur me “Hapësirat që mungojnë për të rinjtë”, nga 40 pjesëmarrës në total, u përgjigjën 38 të rinj dhe të reja. Një pjesë shumë e vogël e tyre e percepton mungesën e hapësirave rekreative si problem kryesor, ku vetëm 1 pjesëmarrës (2.6%) e ka përzgjedhur këtë alternativë. Po ashtu, qendrat rinore janë përzgjedhur nga 3 të rinj (7.9%), çka tregon se nevoja për struktura fizike të reja nuk përbën prioritet dominues në perceptimin e shumicës së të rinjve. Në mënyrë më të moderuar, aktivitetet kulturore dhe sportive janë identifikuar si mungesë nga 4 pjesëmarrës (10.5%), duke reflektuar nevojën për rritjen e frekuencës dhe cilësisë së aktiviteteve, por jo si shqetësimi kryesor. Ndërkohë, gjetja më e rëndësishme e kësaj pyetjeje lidhet me faktin se; mbështetja për talentet e reja dhe platformat për promovimin e tyre janë përzgjedhur secila nga 15 të rinj, përkatësisht 39.5% e pjesëmarrësve për secilën alternativë. Ky rezultat tregon qartë se të rinjtë e Përmetit nuk kërkojnë thjesht hapësira fizike, por mbi të gjitha mundësi konkrete për të zhvilluar, shfaqur dhe promovuar aftësitë, idetë dhe talentet e tyre, Tabela 11.




Tabela 11. Mungesa e hapësirave rinore

Nga përgjigjet del, se prioriteti i të rinjve është kalimi nga pjesëmarrja pasive në fuqizim aktiv, përmes mekanizmave që i ndihmojnë të bëhen të dukshëm, të vlerësuar dhe të mbështetur në fushat ku shfaqin potencial. Kjo nënvizon nevojën që politikatat rinore vendore të fokusohen më pak te infrastruktura klasike dhe më shumë te programet e mbështetjes, promovimit dhe nxitjes së talentëve rinore, si element kyç për angazhimin, motivimin dhe qëndrimin e të rinjve në komunitet.

Pyetja 10. Informimi

Përsa i përket pyetjes, A ndiheni të informuar për mundësitë që ofron bashkia Përmet për të rinjtë?, nga 40 pjesëmarrës në total, u përgjigjën 38 të rinj dhe të reja, çka tregon një nivel të mirë angazhimi në këtë çështje. Rezultatet tregojnë se 18 pjesëmarrës (47.4%) janë shprehur se ndihen të informuar “Po”, ndërsa 15 të rinj (39.5%) kanë deklaruar se ndihen të informuar vetëm “Pjesërisht”. Vetëm 5 pjesëmarrës (13.2%) kanë pohuar se nuk ndihen të informuar për mundësitë që ofron bashkia, **Tabela 12.**




Tabela 12. Informimi

Përgjigjet, tregojnë se shumica e të rinjve (86.9%) kanë të paktën një nivel informacioni mbi mundësitë rinore, qoftë të plotë apo të pjesshëm. Kjo përbën një avantazh të rëndësishëm për Bashkinë Përmet, pasi tregon se kanalet ekzistuese të komunikimit funksionojnë në një masë të konsiderueshme dhe se informacioni arrin të një pjesë e madhe e të rinjve.

Pyetja 11. Rrugët e informimit

Në lidhje me pyetjen se, Cilat platforma mendoni se janë më të përshtatshme për informimin dhe përfshirjen e të rinjve?, nga 40 pjesëmarrës në total u përgjigjën 39 të rinj/reja, çka tregon interes të lartë për mënyrën se si ndërtohet komunikimi dhe përfshirja rinore. Përgjigjet tregojnë se; takimet fizike janë forma më e preferuar e informimit dhe përfshirjes, të zgjedhura nga 16 persona (41%). Kjo dëshmon se të rinjtë vlerësojnë komunikimin e drejtpërdrejtë, dialogun ballë për ballë dhe mundësinë për të shprehur mendimin e tyre në mënyrë aktive dhe të menjëhershme. Në vend të dytë renditen rrjetet sociale, të zgjedhura nga 12 të rinj/reja (30.8%), të cilat perceptohen si mjete të shpejta, të aksesueshme dhe të përshtatshme për informim të vazhdueshëm. Ndërkohë, shkollat dhe institucionet arsimore janë përzgjedhur nga 8 pjesëmarrës (20.5%), duke u konsideruar si hapësira të rëndësishme formale për informim dhe ndërgjegjësim, veçanërisht për nxënësit e arsimit parauniversitar. Ndërsa, 3 persona (7.7%) kanë zgjedhur platformën online të bashkisë, çka tregon se kjo formë komunikimi aktualisht ka ndikim më të kufizuar te të rinjtë. Tabela 13:




Tabela 13: Rrugët e informimit

Gjetjet kryesore tregojnë qartë se të rinjtë preferojnë forma **interaktive dhe të drejtpërdrejta** të komunikimit, ku ndihen të dëgjuar dhe të përfshirë realisht. Dominimi i takimeve fizike dhe rrjeteve sociale sugjeron se bashkia Përmet duhet të fokusohet në kombinimin e këtyre dy kanaleve, duke i përdorur shkollat si pika kyçe ndërmjetëse për shpërndarjen e informacionit. Ndërkohë që, niveli i ulët i përzgjedhjes së platformës online të bashkisë tregon nevojën për përmirësim të aksesueshmërisë, përmbajtjes dhe promovimit të saj, në mënyrë që të kthehet në një mjet më funksional dhe tërheqës për rininë.

PYETJA 12: Sugjerime konkrete për përmirësimin e jetës së të rinjve në Bashkinë Përmet

Në pyetjen e hapur “Çfarë sugjerimesh konkrete do të kishit për përmirësimin e jetës së të rinjve në Bashkinë Përmet?”, nga 40 pjesëmarrës në pyetësor, 19 të rinj/ reja (50%) kanë dhënë opinionet e tyre. Ky nivel përgjigjeje tregon se një pjesë domethënëse e të rinjve kanë nevojë dhe gatishmëri për të artikuluar pritshmëritë e tyre, duke ofruar informacion cilësor të vlefshëm për hartimin e politikave rinore vendore. Analiza tematike e përgjigjeve evidenton disa drejtime prioritare, të cilat përputhen drejtpërdrejt me objektivat strategjike të Planit Vendor të Rinisë 2026–2029.

1. Punësimi dhe zhvillimi ekonomik lokal si kusht për qëndrimin e të rinjve (Objektivi strategjik: Mbështetja financiare, punësimi dhe sipërmarrja rinore)

Një nga temat më të theksuara në përgjigjet e të rinjve lidhet me mungesën e perspektivës ekonomike dhe largimin e vazhdueshëm të rinisë nga Përmeti. Të rinjtë e shohin punësimin dhe zhvillimin ekonomik jo vetëm si nevojë individuale, por si kusht themelor për mbijetesën dhe rigjallërimin e komunitetit lokal.

Të rinjtë shprehen se:



- “Të mbështeten të rinjtë në tregun e punës pasi qytetit të Përmetit po i ikën rinia po boshatiset”.
- “Mungesa e hapësirave të punës”.
- “Punësimi edhe të ardhura ekonomike”.
- “Plan zhvillues për zhvillimin ekonomik të qytetit dhe zonës duke u bazuar në burimet lokale si bujqësia, blegtoria dhe turizmi.” **Tabela 15**

Punësimi dhe zhvillimi lokal si kusht për qëndrimin e të rinjve

“Plan zhvillues për zhvillimin ekonomik të qytetit dhe zonës duke u bazuar në burimet lokale si...”	“Punësimi edhe të ardhura ekonomike.”	“Mungesa e hapësirave të punës.”	“Të mbështeten...”
☐ “Të mbështeten të rinjtë në tregun e punës pasi qytetit të Përmetit po i ikën rinia po boshatiset.”			
☐ “Mungesa e hapësirave të punës.”			
☐ “Punësimi edhe të ardhura ekonomike.”			
☐ “Plan zhvillues për zhvillimin ekonomik të qytetit dhe zonës duke u bazuar në burimet lokale si bujqësia, blegtoria dhe turizmi.”			

Tabela 15; Punësimi dhe zhvillimi ekonomik lokal si kusht për qëndrimin e të rinjve

Përgjigjet tregojnë qartë nevojën për politika rinore që lidhen drejtpërdrejt me ekonomin dhe zhvillimin e burimeve lokale dhe krijimin e vendeve të punës të qëndrueshme për të rinjtë.

2. Arsimi joformal, trajnimet profesionale dhe orientimi drejt tregut të punës

(Objektivi strategjik: Edukimi joformal dhe rritja e aftësive të të rinjve)

Një tjetër grup i rëndësishëm sugjerimesh lidhet me nevojën për zhvillimin e aftësive praktike dhe profesionale, përmes kurseve falas, trajnimeve dhe orientimit profesional. Të rinjtë kërkojnë masa konkrete që i pajisin me kompetenca të përdorshme në tregun e punës.

Përgjigjet përfshijnë:

- “Organizimin e trajnimeve profesionale dhe kurseve falas për aftësi praktike”.
- “Më shumë aktivitete cilësore, trajnime dhe certifikime”.
- “Hapja e kurseve profesionale falas”.
- “Mbështetje për arsimin dhe orientimin profesional përmes këshillimit për karrierën.”

Tabela 16




Tabela 16: Arsimi joformal, trajnimet profesionale dhe orientimi drejt tregut të punës

Gjetje tregojnë se ndërhyrjet në fushën e arsimit joformal duhet të jenë të planifikuara, të vazhdueshme dhe të lidhura ngushtë me nevojat reale të tregut lokal dhe rajonal të punës.

3. Mbështetja e ideve rinore dhe sipërmarrjes së re

(Objektivi strategjik: Nxitja e inovacionit dhe sipërmarrjes rinore)

Të rinjtë shprehin qartë nevojën për mbështetje konkrete për iniciativat e tyre, përfshirë bizneset e vogla, projektet komunitare dhe idetë inovative. Kërkesa kryesore lidhet me skema të thjeshta, të aksesueshme dhe jo burokratike.

Në mënyrë të drejtpërdrejtë, ata sugjerojnë:

- "Mbështetje për biznese të reja rinore".
- "Grante të vogla për projekte të ideuara nga të rinjtë".
- "Të mbështeten dhe nxiten sipërmarrjet rinore". Tabela 16



Tabela 16: Mbështetja e ideve rinore dhe sipërmarrjes së re



Këto sugjerime mbështesin nevojën për krijimin e mekanizmave financiarë dhe teknikë që nxisin iniciativën rinore dhe rrisin angazhimin ekonomik të të rinjve në territorin e bashkisë.

4. Hapësira rinore, aktivitete kulturore, sportive dhe sociale

(Objektivi strategjik: Hapësirat dhe infrastruktura rinore; kultura dhe sporti)

Një tjetër temë e përsëritur është mungesa e hapësirave dhe aktiviteteve të qëndrueshme për të rinjtë. Kërkesa nuk lidhet vetëm me evente sporadike, por me krijimin e mjediseve funksionale dhe programeve të vazhdueshme.

Të rinjtë theksojnë se:

- “Duhet të krijohen më shumë hapësira rinore për aktivitete sociale dhe kulturore”.
- “Të kenë më shumë mundësi për të bërë vetë aktivitete”.
- “Më shumë socialitet, komunikim dhe projekte”.
- “Të shtohen aktivitetet sportive dhe argëtuese për të rinjtë”. **Tabela 17**



Tabela 17: Hapësira rinore, aktivitete kulturore, sportive dhe sociale

Kjo tregon nevojën për investime në infrastrukturë rinore dhe përfshirjen aktive të të rinjve në planifikimin dhe organizimin e aktiviteteve.

5. Pjesëmarrja reale në vendimmarrje dhe roli i Këshillit Rinor Vendor

(Objektivi strategjik: Përfaqësimi, konsultimi dhe bashkëqeverisja me të rinjtë)

Një dimension thelbësor i sugjerimeve lidhet me kërkesën për pjesëmarrje reale dhe jo formale në vendimmarrjen lokale. Të rinjtë kërkojnë mekanizma funksionalë, të rregullt dhe me ndikim konkret.



Në këtë drejtim, ata shprehen se:

- “Duhet aktivizimi real i Këshillit Rinor Vendor me buxhet të dedikuar”.
- “Duhet të ketë konsultime të rregullta me të rinjtë për vendime lokale”.
- “Të rinjtë duhet të përfshihen në hartimin e strategjive të zhvillimit të qytetit”.
- “Të merren pjesë në aktivitetet vendimmarrëse të bashkisë”. **Tabela 18**



Tabela 18: Pjesëmarrja reale në vendimmarrje dhe roli i Këshillit Rinor Vendor

Këto gjetje theksojnë rëndësinë e institucionalizimit të pjesëmarrjes rinore si pjesë integrale e qeverisjes vendore. Sugjerimet e të rinjve dhe të rejave tregojnë se prioritetet e tyre përqendrohen në krijimin e kushteve për një jetë të qëndrueshme në Përmet, përmes punësimit, aftësimit profesional, mbështetjes së iniciativave rinore, zhvillimit të hapësirave sociale dhe përfshirjes reale në vendimmarrje. Këto gjetje përbëjnë një bazë të fortë evidencash për formulimin e masave dhe programeve të Planit Vendor të Rinisë 2026–2029, duke garantuar që ky plan të reflektojë drejtpërdrejt zërin dhe nevojat reale të të rinjve të Bashkisë Përmet.

Pyetja 13 - Nevoja për investime

Nga 40 pjesëmarrës, 21 të rinj (52.5%) dhanë përgjigje të argumentuara për pyetjen: “Nëse Bashkia Përmet do të investonte më shumë fonde për të rinjtë, ku mendoni se duhet të përqendrohej dhe pse?”. Nga përgjigjet e hapura të tyre, del qartë se fokusi më i madh i të rinjve është arsimi, formimi profesional dhe lidhja me punësimin, të shoqëruara me kërkesën për hapësira rinore funksionale dhe aktivitete zhvilluese. Kjo shprehet drejtpërdrejt në përgjigjen: “Mendoj se fondet duhet të përqendrohen te arsimi, punësimi dhe hapësirat rinore...” (Përgjigja 1), si edhe në formulime të ngjashme, p.sh. “Fondet duhet të përqendrohen te arsimi, aktivitetet rinore dhe punësimi...” (Përgjigja 9) dhe “Teajtime kurse punësime arsim” (Përgjigja 10). Një pjesë e të rinjve e lidh këtë drejtim me arsyen kryesore të largimit nga qyteti: “Shumë të rinj largohen nga Përmeti për shkak të mungesës së mundësive për zhvillim profesional...” (Përgjigja



5) dhe “kjo është e rëndësishme sepse shumë të rinj largohen nga Përmeti për mungesë mundësish arsimore dhe profesionale” (Përgjigja 19). Në mënyrë të përsëritur, investimi në kurse profesionale dhe aftësi konkrete del si zgjidhja më e artikuluar: “Ne kurse për të rinjtë që ata të zhvillojnë aftësitë e tyre” (Përgjigja 3); “Investimi në kurse profesionale, trajnime teknologjike, gjuhë të huaja dhe orientim në karrierë...” Përgjigja 5); “Kurse profesionale, punësime, mbështetje ekonomike për të rinjtë” (Përgjigja 17). Edhe kur flitet për investim të arsimit, disa përgjigje e japin si kritikë të drejtpërdrejtë: “Mendoj se duhet të investonte të arsimi pasi arsimi lë për të dëshiruar.” (Përgjigja 4), ndërsa të tjera e lidhin arsimin me rezultat konkret në punësim dhe zhvillim të komunitetit: “Një i ri i aftësuar është një burim i çmuar për komunitetin.” (Përgjigja 5). Një shtyllë e dytë e fortë është punësimi dhe mbështetja reale ekonomike / sipërmarrja rinore, ku kërkohet ndërhyrje praktike dhe jo formale. Kjo shprehet qartë te: “Së dyti, fondet duhet të përqendrohen te punësimi i të rinjve... praktika të paguara, subvencione... nisma për sipërmarrje rinore.” (Përgjigja 20), si edhe te kërkesa për “Tek mbështetja e sipërmarrjeve rinore... Mbështetja të jetë reale dhe jo burokratike...” (Përgjigja 18). Po në këtë vijë logjike është edhe: “Për të hapur m shumë vende pune me ekonomi dhe kurse për të rinjtë sepse jemi shumë mbrapa” (Përgjigja 16). Paralelisht, disa të rinj e shohin të domosdoshme që investimi të shkojë edhe te qendrat rinore dhe hapësirat e organizimit, si: “Me shumë me qendrat rinore” (Përgjigja 6) dhe te logjika se hapësirat rinore ndikojnë “pozitivisht në zhvillimin social dhe kulturor” (Përgjigja 1). Një tjetër grup përgjigjesh fokusohen te sporti dhe mirëqenia, jo si luks, por si masë parandaluese: “Përmirësimi i palestrave, fushave sportive dhe hapësirave të hapura... i larguar nga vërsjet negative” (Përgjigja 21) dhe “Te investonte për aktivitete sportive për aktivitete kulturore” (Përgjigja 13). Në dimensionin kulturor dhe identitar, disa të rinj kërkojnë investime për trashëgimi dhe talente, duke e lidhur me vlera lokale dhe potencial zhvillimi: “Ne trashëgiminë e vlerave kulturore të të rinjtë (këngë, kulinari, valle, instrumente, muzikore)...” (Përgjigja 11); “Ne kulture sepse ka talente” (Përgjigja 15); si dhe orientimin ekonomik: “Turizmi sepse është në zhvillim e siper” (Përgjigja 12). Kjo tregon që për një pjesë të rinisë, zhvillimi rinor nuk shihet vetëm si punësim klasik, por edhe si forcim i potencialeve lokale. Një element tjetër është angazhimi qytetar dhe vullnetarizmi, ku fondet shihen si mjet edukimi social dhe aktivizimi komunitar: “Programe vullnetariteti dhe angazhimi qytetar: Projekte për pastrimin e mjedisit dhe ndihmë sociale...” (Përgjigja 7). Ndërsa një përgjigje e lidh drejtimin e fondeve me vetëvullnetin e të rinjve: “mendoj se duhet të fokusoheshin aty ku të rinjtë dëshirojnë të fokusoheshin” (Përgjigja 8), që në planifikim përkthehet si nevojë për mekanizma konsultimi dhe bashkëvendimmarrjeje. Edhe pse në minorancë, del një qëndrim skeptik për kapacitetin real të bashkisë për të prodhuar ndryshim: “bashkia Permet nuk mund të bëjë dot gjë... nuk duhet të investojë sepse do të ishte një investim i shkuar dem.” (Përgjigja 2). Kjo përgjigje është e rëndësishme sepse sinjalizon se, për një pjesë të rinisë, problemi nuk është vetëm “ku të investohet”, por si të garantohet që investimi të jetë efektiv, i qëndrueshëm dhe me ndikim real. **Tabela 19**



	Aspekti kryesor	Përshkrimi i shkurtër	Nr.	%
1	Arsim & Formim Profesional	Kurse profesionale, trajnime, aftësi praktike, arsim cilësor, formim digjital/emocional	8	38.1
2	Punësim & Sipërmarrje Rinore	Punësim i të rinjve, praktika të paguara, subvencione, mbështetje ekonomike, sipërmarrje	6	28.6
3	Hapësira / Qendra Rinore & Aktivitetet Rinore	Qendra rinore, hapësira rinore, aktivitete rinore, angazhim social	3	14.3
4	Sport & Kulturë	Terrene sportive, palestra, aktivitete kulturore, promovim talentesh	3	14.3
5	Turizëm & Trashëgimi Kulturore	Turizëm lokal, tradita, trashëgimi kulturore si burim zhvillimi	1	4.70

Tabela 19: Nevoja për investime

Një përqindje e vogël, por domethënëse, shpreh skepticizëm mbi kapacitetin real të bashkisë për të investuar më shumë, duke argumentuar se mungojnë burimet njerëzore dhe ekonomike; kjo nënvizon nevojën që masat e planit të lidhen me partneritete, programe kombëtare/rajonale dhe forma bashkëfinancimi.




Tabela 20: Nevoja për investime

Përgjigjet e të rinjve dhe të rejave (të renditura “siç i kanë shprehur”) - Pyetja 13

(21 përgjigje)

1. “Mendoj se fondet duhet të përqendrohen te arsimi, punësimi dhe hapësirat rinore...”
2. “Përsëri e them që bashkia Permet nuk mund të bëj dot gjë...”



3. “Në kurse për të rinjtë që ata të zhvillojnë aftësitë e tyre”
4. “Mendoj se duhet të investonte te arsimi pasi arsimi lë për të dëshiruar.”
5. “Së pari, arsimi dhe aftësitë profesionale duhet të jenë prioritet...”
6. “Me shumë në qendrat rinore”
7. “Programe vullnariteti dhe angazhimi qytetar...”
8. “Tek marrja e dijës së tyre...”
9. “Fondet duhet të përqendrohen te arsimi, aktivitetet rinore dhe punësimi...”
10. “Trajnime, kurse, punësime, arsim”
11. “Në trashëgimin e vlerave kulturore te të rinjtë...”
12. “Turizmi sepse është në zhvillim e sipër”
13. “Të investonte për aktivitete sportive për aktivitete kulturore”
14. “Arsimim dhe formim emocional”
15. “Në kulturë sepse ka talente”
16. “Për të hapur më shumë vende pune...”
17. “Kurse profesionale, punësime, mbështetje ekonomike për të rinjtë”
18. “Tek mbështetja e sipërmarrjeve rinore dhe në rritje kapacitetesh...”
19. “Fondet të kalojnë drejtpërdrejtë tek të rinjtë.”
20. “Mbështetja të jetë reale dhe jo burokratike.”
21. “Përmirësimi i palestrave, fushave sportive...”

Pyetja 14 – Çfarë do t’i kërkonit Bashkisë Përmet të përmirësonte ose të zhvillonte më shumë në lidhje me aktivitetet për të rinjtë (kulturore, sportive, edukative, sociale)?

Nga 40 pjesëmarrës në pyetësor, 18 të rinj dhe të reja (45%) dhanë përgjigje të argumentuara lidhur me përmirësimet apo zhvillimet që bashkia Përmet duhet të ndërmarrë në fushën e aktiviteteve kulturore, sportive, edukative dhe sociale. të rinjtë kërkojnë që aktivitetet për rininë në Përmet të mos mbeten të shpërndara, të rralla apo “simbolike”, por të kthehen në një program të rregullt, të planifikuar dhe me mbështetje reale. Kjo ide artikullohet qartë nga një pjesëmarrës që thekson se aktivitetet duhet “të planifikohen në mënyrë të qëndrueshme, me buxhet të dedikuar dhe me përfshirjen direkte të të rinjve në organizim”, sepse vetëm kështu të rinjtë ndihen të vlerësuar dhe të motivuar për të kontribuar në zhvillimin e qytetit (Përgjigja 5). Në të njëjtën linjë, një tjetër përgjigje kërkon “më shumë mbështetje ekonomike për aktivitete që zhvillojnë të rinjtë” (Përgjigja 6), ndërsa të tjerë e formulojnë në mënyrë më të gjerë si nevojë për “gjithëpërfshirje, më shumë aktivitete, më shumë mundësi punësimi apo trajnime” (Përgjigja 10). Kërkesat grupohen rreth katër shtyllave kryesore: kulturë, sport, edukim dhe aktivitete sociale. Për kulturën, kërkohet zgjerim dhe rritje e shpeshtësisë së aktiviteteve—nga festivale, teatro dhe veprimtari artistike që nxisin kreativitetin (Përgjigja 1), deri te përgjigje më të shkurtra por domethënëse si “Kultura” (Përgjigja 14) dhe “Aktivitetet kulturore të jene me të shpeshta” (Përgjigja 13). Kultura shihet edhe si mënyrë për të nxitur talentin dhe pjesëmarrjen aktive të të rinjve (Përgjigja 9). Për sportin, një pjesë e mirë e përgjigjeve e vendosin si prioritet kryesor. Disa e thonë drejtpërdrejt “Më tepër te sporti” (Përgjigja 4) ose “Aktivitetet sportive” (Përgjigja 16), ndërsa të tjerë argumentojnë më gjatë se nevojiten më shumë terrene, palestra dhe turne, madje edhe aktivitete sportive falas (Përgjigja 1 dhe Përgjigja 17). Sporti lidhet jo vetëm me



argëtimin, por me shëndetin fizik e mendor, bashkëpunimin, disiplinën dhe parandalimin e zakoneve të dëmshme (Përgjigja 17), si edhe me mirëqenien e përgjithshme të të rinjve (Përgjigja 13). Në dimensionin edukativ, theksi shkon te kurset dhe trajnimet që rrisin aftësitë praktike dhe mundësitë e punësimit. Të rinjtë kërkojnë kurse pas orarit mësimor në shkolla (gjimnaz dhe 9-vjeçare) me aktivitete të ndryshme, përfshirë sportive e kulturore (Përgjigja 2), si edhe “kurse, trajnime dhe ëorkshope” që ndihmojnë zhvillimin profesional (Përgjigja 1). Disa përgjigje e konkretizojnë më tej: kurse për kompjuter, zanate, trajnime për leadership dhe mendim kritik, sepse përgatisin të rinjtë për tregun e punës dhe rrisin mundësitë për sipërmarrje ose punësim (Përgjigja 7). Po kështu, kërkojnë kurse dhe trajnime profesionale në gjuhë të huaja, teknologji dhe aftësi praktike, për t'i bërë të rinjtë më konkurrues (Përgjigja 18). Në një vështrim më të gjerë, disa e përmbledhin thjesht si “Hapin kurse me shumë...” (Përgjigja 15), por logjika mbetet e njëjtë: edukimi praktik dhe aftësimi janë çelësi. Aktivitetet sociale shihen si hapësirë jo vetëm për bashkëpunim, por edhe për informim dhe përfshirje komunitare. Një pjesëmarrës thekson se aktivitetet sociale forcojnë bashkëpunimin dhe përfshirjen e të rinjve në komunitet (Përgjigja 1), ndërsa një tjetër nënvizon se duhen aktivitete sociale sepse përmes tyre të rinjtë “mund edhe të informohen” (Përgjigja 12). Kjo ide lidhet edhe me kërkesën për aktivitete sociale, vullnetare dhe kulturore (Përgjigja 18), duke sugjeruar se rinia kërkon platforma ku të jetë aktive, e dukshme dhe e lidhur me jetën publike. Në tërësi, edhe përgjigjet më të shkurtra—si “Çdo gjë” (Përgjigja 3), “Të gjitha fushat!” (Përgjigja 11) apo “Bashkia duhet të zhvillojë më shumë aktivitete...” (Përgjigja 9)—tregojnë se pritshmëria është për një qasje gjithëpërfshirëse. Megjithatë, brenda këtij spektri, dalin dy mesazhe të qarta: (1) aktivitetet duhet të jenë të vazhdueshme dhe të organizuara me buxhet e pjesëmarrje direkte të të rinjve (Përgjigja 5), dhe (2) prioritetet konkrete janë sporti, kultura dhe aftësimi edukativ/profesional, të kombinuara me aktivitete sociale që rrisin informimin, bashkëpunimin dhe angazhimin komunitar (Përgjigjet 1, 7, 13, 17, 18).

Aspekti kryesor		Përmbajtja e kërkesës së të rinjve	Nr. përgji gjeve	%
1	Edukim, kurse dhe trajnime	Kurse pas orarit në shkolla, trajnime profesionale, aftësi praktike (IT, zanate), ëorkshope, leadership, mendim kritik	8	44.40%
2	Sport dhe aktivitete sportive	Terrene sportive, palestra, turne, aktivitete sportive të shpeshta dhe falas	7	38.90%
3	Kulturë dhe art	Aktivitete kulturore, festivale, teatër, aktivitete artistike, promovim i talenteve kulturore	6	33.30%
4	Gjithëpërfshirje (të gjitha fushat)	Kërkesë për përmirësim të përgjithshëm në të gjitha fushat	3	16.70%



5	Aktivitetet sociale dhe vullnetare	Aktivitetet sociale, vullnetare dhe komunitare për informim dhe bashkëpunim	3	16.70%
6	Planifikim i qëndrueshëm & përfshirje rinore	Aktivitetet të rregullta, jo simbolike; buxhet i dedikuar; përfshirje e të rinjve në organizim	2	11.10%
7	Mbështetje ekonomike për nisma rinore	Mbështetje financiare direkte për aktivitetet e zhvilluara nga të rinjtë	1	5.60%

Tabela 21:

Shënim metodologjik: Përqindjet nuk japin total 100%, pasi disa të rinj kanë përmendur më shumë se një aspekt në të njëjtën përgjigje.

Përgjigjet e të rinjve dhe të rejave – Pyetja 14

(18 përgjigje)

1. “Do t’i kërkoja Bashkisë të zhvillonte më shumë aktivitete kulturore si festivale, teatro...”
2. “Ne shkollat (gjimnaz dhe 9 vjecare) te kete kurse mbas orarit shkollor...”
3. “Cdo gje”
4. “Mendoj se të katërta kanë nevoj për përmirësim por më tepër te sporti.”
5. “Aktivitetet të mos jenë të rralla apo simbolike, por të planifikohen...”
6. “Me shume mbeshtetje ekonomike per aktivitet qe zhvillojne te rinjte”
7. “Aktivitetet edukative: kurse per aftesi praktike kompjuter, zanate...”
8. “Cdo gje eshte ne rregull... kerkohet me shume pak pune dhe rregull.”
9. “Më shumë aktivitete kulturore dhe sportive, si edhe trajnime edukative...”
10. “Gjithëpërfshirje, me shum aktivitete, me shume mundesi punesimi...”
11. “Te gjitha fushat!”
12. “Mendoj se duhen aktivitete sociale sepse te rinjte mund edhe te informohen...”
13. “Aktivitetet kulturore te jene me te shpeshta...”
14. “Kultura”
15. “Hapin kurse me shum aktivitete...”
16. “Aktivitetet sportive”
17. “Kërkohet investim më i madh në terrene sportive...”
18. “Duhet të zhvillohen kurse edukative dhe trajnime profesionale...”



V. VIZIONI DHE OBJEKTIVAT

5.1 VIZIONI

Vizioni i Planit Strategjik Vendor për Rininë të Bashkisë Përmet është krijimi i një mjedisi ku të rinjtë zgjedhin të qëndrojnë, të zhvillohen dhe të ndërtojnë të ardhmen e tyre në Përmet, duke parë qytetin dhe njësitë administrative jo si pika tranziti, por si hapësira reale mundësish. Ky vizion buron drejtpërdrejt nga gjetjet e pyetësorit rinor, ku emigrimi dhe largimi i të rinjve u identifikua si sfida më shqetësuese për komunitetin. PSVR synon të adresojë këtë “plagë sociale” përmes politikave konkrete që rrisin perspektivën lokale të të rinjve, duke ofruar arsim funksional, aftësi të kërkuara nga tregu i punës, punësim, hapësira zhvillimi, pjesëmarrje dhe mirëqenie sociale. Plani synon një rini aktive, të aftësuar, të përfshirë dhe të përfaqësuar, me akses të barabartë në mundësi zhvillimi dhe me rol aktiv në jetën publike dhe vendimmarrjen lokale. Në këtë kuadër, Bashkia Përmet angazhohet të krijojë kushte që të rinjtë të shohin të ardhmen e tyre të lidhur me zhvillimin e komunitetit ku jetojnë. PSVR harmonizohet me Strategjinë Kombëtare për Rininë 2022–2029 dhe Strategjinë Europiane për të Rinjtë, duke synuar zhvillim të qëndrueshëm lokal, kohezion social dhe forcim të kapitalit njerëzor rinor.

5.2 OBJEKTIVAT STRATEGJIKË TË PLANIT VENDOR RINOR

(të ndërtuara mbi gjetjet e pyetësorit dhe prioritetet e të rinjve)

Bazuar në analizën e situatës aktuale dhe në përgjigjet e të rinjve të Bashkisë Përmet, Plani Vendor Rinor strukturohet mbi pesë objektiva strategjikë, të cilët synojnë drejtpërdrejt uljen e emigrimit dhe rritjen e perspektivës lokale për të rinjtë:

OBJEKTIVI STRATEGJIK 1: HAPËSIRAT DHE INFRASTRUKTURA RINORE

Përmirësimi i infrastrukturës dhe aksesit të të rinjve në hapësira komunitare, edukative dhe rekreative.

SITUATA AKTUALE	OBJEKTIVAT STRATEGJIK	NDIKATORET NE %	AKTIVITETE T KRYESORE	FINANCIM BASHKIA	FINANCIM DONATOR, OJF TË NDRYSHME
Gjetjet tregojnë se nevojat kryesore të të rinjve lidhen me mungesën e mekanizmave të	OS1.1 Sigurimi i hapësirave rinore funksionale dhe të aksesueshme në zonën urbane dhe	I.1. 100% e Njërive Administrative + zona urbane të kenë të paktën 1 pikë rinore funksionale	A1. Krijimi/përshtatja e Pikave Rinore në qytetin Përmet	100,000 (viti 2026)	350,000 Lekë (viti 2026)



qëndrueshëm për mbështetjen e talenteve dhe promovimin e ideve rinore (39.5%), si dhe me nevojën për hapësira funksionale dhe aktivitete të aksesueshme edhe në zonat rurale. Informimi për mundësitë ekzistuese është i pjesshëm për një pjesë të konsiderueshme të të rinjve (39.5%), ndërsa format më të preferuara të përfshirjes janë takimet fizike, rrjetet sociale dhe shkollat.	në të gjitha Njësitë Administrative. OS1.2 Krijimi i mekanizmave për mbështetjen e talenteve dhe ideve rinore. OS1.3 Përmirësimi i informimit dhe komunikimit rinor përmes kanaleve të preferuara nga të rinjtë.	deri në 2029. I.1.1. $\geq 40\%$ e pjesëmarrësve në aktivitetet rinore të jenë nga zonat rurale. I.2. $\geq 60\%$ e aktiviteteve të bashkë-prodhuara me të rinjtë; $\geq 50\%$ përfitues vajza/të reja. I.3. $\geq 65\%$ e të rinjve të raportojnë se janë “të informuar mirë” për mundësitë e Bashkisë. I3.1. $\geq 70\%$ e njoftimeve shpërndahen në 3 kanale (fizik + social + shkolla).	dhe në Njësitë Administrative: Çarshovë, Petran, Qendër Piskovë, Frashër (pajisje bazë, kalendar aktiviteteve). A1.1. Kalendar vjetor aktiviteteve ndërkolllore dhe ndërnjësish (sport, kulturë, punëtori rinor) me rotacion territorial. A2. Programi “Talente & Ide Rinore” (mikro-grante + event vjetor promovimi për ide rinore). A3. Paketë informimi 3-kanalësh: takime fizike periodike, rrjete sociale dhe shkolla/institucione arsimore (kalendar rinor).	100,000 (viti 2026) 200.000 (viti 2027) 200,000 (viti 2027)	200,000 (viti 2026) 1,000,000 (viti 2027) 500 000 (viti 2027)
---	---	---	--	---	---



--	--	--	--	--	--

OBJEKTIVI STRATEGJIK 2: PUNËSIMI DHE SIPËRMARRJA RINORE

Nxitja e punësimit dhe sipërmarrjes rinore përmes zhvillimit të aftësive, inovacionit dhe mbështetjes ekonomike.

SITUATA AKTUALE	OBJEKTIVAT STRATEGJIK	INDIKATORET NE %	AKTIVITETE T KRYESORE	FINANCIM BASHKIA	FINANCIM DONATOR, OJF TË NDRYSHME
Gjetjet e pyetësorit tregojnë se papunësia rinore, mungesa e tregut të punës dhe emigrimi janë ndër sfidat kryesore për të rinjtë në Bashkinë Përmet. Mbi gjysmën e përgjigjeve të hapura theksojnë nevojën për investim në arsimim praktik, kurse profesionale, punësim dhe mbështetje për sipërmarrje rinore, veçanërisht në sektorë me potencial lokal si	OS2.1 Rritja e punësimit së të rinjve përmes formimit të profesional të orientuar nga tregu lokal i punës. OS2.2 Krijimi i skemave të praktikave të paguara (internship/traineeship) në bashkëpunim me bizneset dhe institucionet lokale.	I1. $\geq 60\%$ e të rinjve pjesëmarrës në kurse profesionale të certifikuara deri në 2029. I.1.1. $\geq 50\%$ e përfituesve nga zonat rurale dhe Njësitë Administrative. I.2. $\geq 40\%$ e pjesëmarrësve në praktika të përfshihen në punësim pas përfundimit të programit I3. $\geq 30\%$ e ideve rinore të mbështetura të kalojnë në fazë	A1. Organizimi i kurseve profesionale të certifikuara (turizëm, guida lokale, përpunim produkteve tradicionale, shërbime, teknologji bazë), me shpërndarje territoriale urbane dhe A2. Skemë vjetore praktikash të paguara për të rinjtë në bashkëpunim me biznese lokale, institucione publike dhe subjekte turistike të mbështetur	100.000 (viti 2026) 200.000 (viti 2028)	400.000 (viti 2026) 2.500.000 (viti 2028)



turizmi, bujqësia, përpunimi i produkteve tradicionale, shërbimet dhe ekonomia kreative. Mungojnë skemat e strukturuar të praktikave të paguara dhe mekanizmat mbështetës për të rinjtë në zonat rurale.	OS2.3 Nxitja e sipërmarrjes rinore dhe vetëpunësimit në sektorë prioritarë lokalë.	funksionale (biznes/nismë). I3.1. $\geq 50\%$ e përfituesve vajza/të reja dhe $\geq 40\%$ nga zonat rurale.	edhe nga donatorë. A3. Program “Start-up Rinor Permet”: mikro-grante, mentorim, këshillim dhe mbështetje teknike për ide biznesi rinore të mbështetura edhe nga donatorë.	100.000 (viti 2028)	3.000.000 (viti 2028)
--	--	--	--	----------------------------	------------------------------

OBJEKTIVI STRATEGJIK 3: PJESËMARRJA DHE PËRFAQËSIMI RINOR NË VENDIMMARRJEN LOKALE (i ndërtuar drejtpërdrejt mbi gjetjet e Pyetjeve 6, 7 dhe 8 të pyetësorit)

Rritja e përfshirjes aktive të të rinjve në hartimin dhe zbatimin e politikave lokale.

SITUATA AKTUALE	OBJEKTIVAT STRATEGJIK	NDIKATORET NE %	AKTIVITETE T KRYESORE	FINANCIM BASHKIA	FINANCIM DONATOR, OJF TË NDRYSHME
Gjetjet e pyetësorit tregojnë se përfshirja e të rinjve në vendimarrjen lokale perceptohet si e pamjaftueshme. 59% e të rinjve	OS3.1 Rritja e përfshirjes reale dhe të qëndrueshme të të rinjve në proceset e vendimarrjes lokale. OS3.2	I1. $\geq 65\%$ e të rinjve raportojnë përfshirje reale në konsultime lokale deri në vitin 2029. I2. Këshilli Rinor	A1. Organizimi i takimeve periodike të drejtpërdrejta “Bashkia dëgjon të rinjtë” në qytet dhe në 4 Njësitë Administrative. A2. Riorganizim, trajnimi dhe	50.000 (viti 2026)	100 000 (viti 2026)



deklarojnë se përfshihen vetëm “pjesërisht”, 38% “jo”, ndërsa vetëm 3% mendojnë se përfshirja është e mjaftueshme. Të rinjtë kërkojnë kryesisht forma direkte të pjesëmarrjes, si takime të drejtpërdrejta me Bashkinë, funksionalizimin e Këshillit Rinor Vendor dhe konsultime publike reale. Mungojnë mekanizma të strukturuar, të rregullt dhe gjithëpërfshirës, veçanërisht për të rinjtë e zonave rurale.	Funksionalizimi dhe forcimi i mekanizmave rinorë të përfaqësimit. OS3.3 Rritja e kapaciteteve të të rinjve për qytetari aktive dhe advokim.	Vendor funksional me $\geq 70\%$ pjesëmarrje aktive vjetore. I3. $\geq 60\%$ e pjesëmarrësve rrisin njohuritë mbi vendimmarrjen lokale (vlerësuar përmes pyetësorëve para/pas). I4. $\geq 40\%$ e pjesëmarrësve nga Njësitë Administrative rurale. I5. $\geq 50\%$ e pjesëmarrësve vajza/të reja.	mbështetja logjistike e Këshillit Rinor Vendor, me përfaqësim urban dhe rural. A3. Trajnime mbi qytetarinë aktive, të drejtat rinore, advokimin dhe	150.000 (viti 2026)	200.000 (viti 2026)
				100.000 (viti 2027)	100.000 (viti 2027)

OBJEKTIVI STRATEGJIK 4: ART, KULTURË, SPORT DHE MJEDIS

(i ndërtuar mbi gjetjet e Pyetjeve 9, 10, 11 dhe 14 të pyetësorit)

Rritja e pjesëmarrjes së të rinjve në jetën kulturore, sportive dhe në iniciativat për mbrojtjen e mjedisit.

SITUATA AKTUALE	OBJEKTIVAT STRATEGJIK	INDIKATORET NE %	AKTIVITETET KRYESORE	FINANCIM BASHKIA	FINANCIM DONATOR, OJF TË
--------------------	--------------------------	---------------------	-------------------------	---------------------	--------------------------------



					NDRYSHME
Gjetjet tregojnë se të rinjtë në Bashkinë Përmet kanë nevojë të shtuar për mbështetje të talenteve dhe për hapësira ku të shprehin krijimtarinë.	OS4.1 Krijimi dhe përmirësimi i hapësirave dhe mundësive për shprehje artistike, kulturore dhe sportive të të rinjve	I1. $\geq 60\%$ e të rinjve raportojnë rritje të pjesëmarrjes në aktivitete kulturore e sportive deri në 2029.	A1. Organizimi i kalendarit vjetor të aktiviteteve kulturore dhe sportive me protagonizëm rinor (urbane dhe rurale).	50.000 (viti 2026)	500 000 (viti 2027)
79% e të rinjve kërkojnë ose mbështetje për talentet e reja (39.5%) ose platforma për promovimin e ideve rinore (39.5%).	OS4.2 Identifikimi, mbështetja dhe promovimi i talentëve të reja në art, kulturë dhe sport.	I2. $\geq 50\%$ e talentëve të identifikuar marrin mbështetje konkrete (evente, promovim, çmime).	A2. Organizimi i konkurseve artistike, kulturore dhe sportive dhe krijimi i platformës "Talent i Përmetit"	200.000 (viti 2026)	300 000 (viti 2027-2028)
Aktivitetet kulturore dhe sportive vlerësohen si të pamjaftueshme, ndërsa mungesa e një qendre rinore funksionale dhe e aktiviteteve të qëndrueshme kufizon përfshirjen, sidomos në zonat rurale.	OS4.3 Rritja e përfshirjes rinore në nisma mjedisore dhe vullnetare.	I3. $\geq 45\%$ e pjesëmarrësve në aktivitete mjedisore janë të rinj 15–29 vjeç.	A3. Nisma rinore për mbrojtjen e mjedisit, pastrim, sensibilizim dhe edukim mjedisor në të 4 Njësitë Administrative.	50.000 (viti 2026)	200 000 (viti 2027-2028)
	OS4.4 Zhvillimi dhe përmirësimi i infrastrukturës recreative dhe sportive për të rinjtë, përmes krijimit dhe rehabilitimit të hapësirave publike në natyrë, me qëllim rritjen e pjesëmarrjes së tyre në aktivitete fizike, sociale dhe	I4. $\geq 40\%$ e pjesëmarrësve nga Njësitë Administrative rurale.	A4. Hartimi i projekteve teknike për terrene sportive dhe kënde recreative.	2 000 000 (viti 2027)	20 000 000 (viti 2027)
		I5. $\geq 50\%$ pjesëmarrje vajza/të reja në aktivitete kulturore dhe sportive.	Ndërtimi dhe /ose rikonstrukcioni i		
		I6. ≥ 30 e numrit të			



	komunitare.	të rinjve që përdorin hapësirat recreative/sportive. Të paktën 1 hapësirë funksionale për të rinjtë në Njësitë Adm. ≥20 % e aktiviteteve komunitare të organizuara në këto hapësira.	terreneve multifunksionale (futboll, basketball, volejboll etj), këndeve recreative (ulëse, gjelbërim, ndricim, wifi, kënde sociale) Pajisje me infrastrukturë mbështetëse. Organizimi i aktiviteteve promovuese		
--	-------------	--	--	--	--

OBJEKTIVI STRATEGJIK 5:. ÇËSHTJET SOCIALE, SHËNDETËSORE DHE SHËRBIMET PUBLIKE

Promovimi i një mjedisi të sigurt, të shëndetshëm dhe mbështetës për të rinjtë në komunitet.

SITUATA AKTUALE	OBJEKTIVAT STRATEGJIK	NDIKATORET NE %	AKTIVITETET KRYESORE	FINANCIM BASHKIA	FINANCIM DONATOR, OJF TË NDRYSHME



Në Bashkinë Përmet, shërbimet sociale dhe shëndetësore për të rinjtë janë të kufizuara dhe kryesisht të përqendruara në qytet. Të rinjtë, veçanërisht në zonat rurale, kanë akses të kufizuar në mbështetje psiko-sociale, informim mbi shëndetin mendor dhe shëndetin seksual, si dhe në aktivitete parandaluese. Nevojitet forcimi i shërbimeve publike për rritjen e mirëqenies sociale dhe shëndetësore të të rinjve.	OS5.1 Përmirësimi i aksesit të të rinjve në informacion. OS5.2 Rritja e aksesit të të rinjve në shërbime psiko-sociale cilësore. OS 5.3 Nxitja e vullnetarizmit dhe qytetarisë aktive të të rinjtë, duke siguruar përfshirje të barabartë të të rinjve me aftësi ndryshe dhe nga komunitetet e marginalizuara.	I1. Minimum 3 të fushata të realizuara në vit. I.1.2. 50% e pjesëmarrësve janë të rinj 15–29 vjeç. I.1.3. 30% e pjesëmarrësve janë nga njësitë administrative rurale. I.2 Minimum 100 të rinj përfitojnë nga seancat këshilluese gjatë periudhës së planit. I.2.1. 40% e përfituesve janë vajza dhe të reja. I.2.3. .25% e përfituesve vijnë nga familje në nevojë sociale. I.3 Minimum 10 nisma vullnetare të realizuara. I.3.1 35% e të rinjve pjesëmarrës janë nga zonat rurale. I.3.2 60% e	A.1. Fushata informuese dhe ndërgjegjësuere për shëndetin mendor, shëndetin seksual dhe parandalimin e varësive në bashkëpunim me Drejtorinë e Shëndetit Publik. A2. Seanca këshillimi dhe mbështetje psiko-sociale për të rinjtë. A3.Angazhimi i të rinjve në nisma sociale dhe vullnetare në komunitet.	50.000 (viti 2027-2028) 100.000 (viti 2026) 300.000 (viti 2027)	200 000 (viti 2027-2028) 500 000 (viti 2027-2029) 1 000 000 (viti 2028-2029)
--	---	--	--	---	--



		pjesëmarrësve raportojnë rritje të ndërgjegjësimit social dhe qytetar			
--	--	--	--	--	--

1. ANALIZA SWOT

Analiza SWOT, tregon se bashkia Përmet ka potencial real rinor dhe vullnet të shprehur për përfshirje, por përballet me sfida serioze si emigrimi, mungesa e punësimit dhe përfshirja e kufizuar në vendimmarrje. PSVR 2026-2029, synon të shfrytëzojë forcat dhe mundësitë ekzistuese për të adresuar dobësitë strukturore dhe për të minimizuar kërcënimet, përmes masave të buxhetuara, gjithëpërfshirëse dhe të orientuara drejt rezultateve konkrete, veçanërisht për të rinjtë në zonat rurale dhe grupet e marginalizuara.

FORCAT	DOBËSITË
Ekzistenca e një qendre rinore funksionale dhe me infrastrukturë të kënaqshme, që përbën një aset të rëndësishëm për zhvillimin e aktiviteteve rinore, edukative, kulturore dhe sociale. Angazhim në rritje i Bashkisë Përmet për çështjet rinore, përfshirë mbështetjen e proceseve konsultuese dhe hartimin e Planit Vendor të Rinisë. Prani e shkollave 9-vjeçare dhe të mesme në territor, që krijojnë bazë për programe rinore edukative dhe aktivitete jashtëshkollore. Interes dhe vullnet i lartë i të rinjve për pjesëmarrje, vullnetarizëm dhe zhvillim personal, i evidentuar përmes pyetësorit. Potencial lokal për zhvillim ekonomik në sektorë si turizmi, kultura, trashëgimia, bujqësia dhe shërbimet.	Emigrimi i të rinjve perceptohet si sfida kryesore, duke reduktuar kapitalin njerëzor dhe perspektivën afatgjatë të territorit. Mundësi të kufizuara për punësim cilësor dhe praktikë profesionale në nivel lokal, veçanërisht për të rinjtë pas përfundimit të shkollës. Pjesëmarrja e të rinjve në vendimmarrjen lokale vlerësohet kryesisht si “pjesërisht” ose “e pamjaftueshme”, me mungesë mekanizmash funksionale dhe të qëndrueshëm. Aktivitetet rinore shpesh janë sporadike dhe jo të programuara në mënyrë afatgjatë, pavarësisht ekzistencës së infrastrukturës. Akses më i kufizuar i të rinjve nga zonat rurale dhe grupet e marginalizuara në aktivitete, informacion dhe shërbime rinore.
MUNDËSITË	KËRCËNIMET
Shfrytëzimi më i plotë i qendrës rinore ekzistuese për programe të strukturuar, gjithëvjetore dhe gjithëpërfshirëse. Mundësi bashkëpunimi me bizneset lokale,	Vazhdimi i tendencës së emigrimit mund të çojë në zbrazje demografike dhe plakje të popullsisë, duke dobësuar zhvillimin lokal. Kufizimet buxhetore të bashkisë mund të



donatorë kombëtarë dhe ndërkombëtarë për punësim, praktika dhe mbështetje të start-up-eve rinore. Integrimi i kërkesave të të rinjve (kurse profesionale, orientim karriere, platforma promovimi) në politikat vendore. Aktivizimi i Këshillit Rinor Vendor dhe krijimi i mekanizmave të rregullt të dialogut Bashki-Rini. Zhvillimi i programeve rinore që lidhin kulturën, turizmin dhe trashëgiminë lokale me aftësimin dhe punësimin e të rinjve.	ndikojnë në zbatimin e plotë të programeve rinore pa mbështetje shtesë. Rreziku që pjesëmarrja rinore të mbetet formale ose simbolike, nëse nuk shoqërohet me ndikim real në vendimmarrje. Pabarazitë mes zonave urbane dhe rurale mund të thellohen nëse ndërhyrjet nuk planifikohen në mënyrë gjithëpërfshirëse. Demotivimi i të rinjve në mungesë të rezultateve konkrete mund të ulë besimin ndaj institucioneve vendore.
---	---

7. MONITORIMI DHE VLERËSIMI I PSVR-së 2026–2029

Monitorimi dhe vlerësimi janë komponentët thelbësor të zbatimit të Planit Strategjik Vendor të Rinisë 2026-2029, pasi sigurojnë ndjekjen sistematike të progresit, rritjen e përgjegjshmërisë institucionale dhe përmirësimin e vazhdueshëm të ndërhyrjeve. Nëpërmjet këtij sistemi, bashkia Përmet merr informacion të strukturuar mbi ecurinë e programeve, nivelin e arritjes së indikatorëve dhe efektin real të masave tek të rinjtë, duke përfshirë edhe të rinjtë, duke përfshirë edhe të rinjtë e zonave rurale dhe ata nga grupe të marginalizuara apo me aftësi ndryshe. Monitorimi ndihmon që suksesi të identifikohet dhe të shtrihet më tej, ndërsa vështirësitë dhe devijimet të adresohen në kohë, përpara se të ndikojnë në përmbushjen e objektivave strategjikë. Për të garantuar raportim cilësor dhe të dobishëm, sistemi i monitorimit dhe vlerësimit të PSVR-së bazohet në tre shtylla kryesore: (a) një proces i qartë raportimi dhe monitorimi me role, përgjegjësi dhe kalendar; (b) modele dhe instrumente të standardizuara për mbledhjen e të dhënave dhe konsolidimin e informacionit; dhe (c) kapacitete të mjaftueshme të strukturave zbatuese dhe monitoruese për të prodhuar raporte analitike të mbështetura në prova.

1) Procesi i monitorimit dhe raportimit

Procesi i monitorimit organizohet në mënyrë të tillë që cdo strukturë të ketë përgjegjësi të qarta për aktivitetet dhe indikatorët që mbulon. Raportimi do realizohet sipas një kalendari të paracaktuar, duke mundur që institucionet dhe partnerët të planifikojnë angazhimet, të dokumentojnë rezultatet dhe të raportojnë në kohë. Monitorimi do sigurojë mbulim të plotë të projekteve/aktiviteteve dhe do të verifikojë në mënyrë të vazhdueshme nëse vazhdueshme



indikatorët po arrihen sipas parashikimeve, si në zonën urbane ashtu edhe në njësitë administrative.

2) Modelet dhe instrumentet e monitorimit

Për të garantuar një rrjedhë të unifikuar komunikimi dhe raportimi, dopërdoren modele standarde (format raportimi) që lehtësojnë konsolidimin e të dhënave dhe krahasimin e progresit ndër vite. Modelet do të shoqërohen me udhëzime të thjeshta për plotësimin e tyre dhe do të përfshijnë, minimalisht: përshkrimin e aktivitetit, periudhën e zbatimit, grupin përfitues, vendndodhjen (urbane/rurale), buxhetin e shpenzuar, indikatorët e arritur (me shifra dhe %) dhe evidencat shoqëruese (lista pjesëmarrjeje, foto, raporte, produkte të aktivitetit). Në rast vonesash, mangësish apo devijimesh serioze nga plani, do kërkohet sqarim i detajuar mbi shkaqet dhe masa korrigjuese. Informacioni i prodhuar nga sistemi i monitorimit përdoret: (a) brenda bashkisë Përmet, për vendimarrje dhe përmirësim të menaxhimit financiar/programor; dhe (b) jashtë institucionit, për transparencë publike dhe rritje besueshmërie ndaj qytetarëve, të rinjve dhe donatorë potencialë.

3) Kapacitetet dhe forcimi i tyre

Raportimi i mirë kërkon jo vetëm të dhëna, por edhe analizë. Praktika shpesh tregon se raportimet fokusohen te veprimet fokusohen te veprimet rutinë (çfarë u bë), duke lënë pas matjen e rezultatit (çfarë ndryshoi). Për këtë arsye, bashkia Përmet do synojë forcimin e kapaciteteve të strukturave përkatëse përmes udhëzimeve, trajnimeve të shkurtra dhe praktikës së përbashkët, në mënyrë që raportet të jenë të qarta, të matshme dhe të mbështetura në prova.

Nivelet e monitorimit dhe vlerësimit

Sistemi i propozuar përbëhet nga dy nivele të lidhura me njëri-tjetrin:

1. Monitorimi i projekteve/aktiviteteve dhe indikatorëve

Ky nivel lidhet me ndjekjen e zbatimit të aktiviteteve dhe arritjen e indikatorëve të përcaktuar në PSVR. Monitorimi realizohet nga strukturat përgjegjëse brenda bashkisë Përmet dhe /ose partnerët zbatues, sipas programeve përkatëse. Raportimit do jetë 6 - 12 muaj, në varësi të natyrës së aktivitetit dhe kohëzgjatjes së tij. Raportet e monitorimit i dërgohen strukturës koordinuese të PSVR-së, e cila konsolidon informacionin dhe sinjalizon në kohë vonesat, rreziqet dhe nevojën për masa korrigjuese.

2. Vlerësimi vjetor i përmbushjes së objektivave dhe rezultateve Vlerësimi

Niveli i dytë lidhet me vlerësimin e arritjeve në raport me objektivat strategjike dhe rezultatet e pritshme. Vlerësimi realizohet në fund të çdo viti kalendarik dhe bazohet në analizën e raporteve 6-12 mujore. Ai do përfshijë: (a) masën e përmbushjes së indikatorëve (krahasimi plan/realizim); (b) analizën e arsyetimit për devijimet; (c) progresin e përfshirjes së të rinjve të zonave rurale dhe grupeve të nën-përfaqësuar; dhe (c) rekomandime për përmirësime. Në raste



të veccanta, vlerësimi mund të propozojë rishikime të aktiviteteve, afateve, buxheteve apo mënyrës së zbatimit, pa cenuar vizionin dhe prioritetet kryesore të planit.

Kalendari orientues i raportimit

-Cedo 6 muaj; Raport i shkurtër i zbatimit për aktivitetet në vijim(progres, përfitues, shpenzime, indikatorë të arritur, problematika).

-Cedo 12 muaj; Raport vjetor i konsoliduar i PSVR-së (analizë e objektivave, rezultatet, rekomandime, nevoja për rishikime).

-Në fund të 2027; rishikim i ndërmjetëm për të vlerësuar nëse prioritetet, programet dhe buxhetet po adresojnë në mënyrë efektive gjetjet kryesore (p.sh. emigrimi/papunësia,nevoja për hapësira rinore, informim dhe shërbime mbështetëse).

-Në fund të vitit 2029; vlerësim përfundimtar i Planit, me përmbledhje të rezultateve, mësimëve dhe rekomandimeve për ciklin pasardhës.

Monitorimi dhe vlerësimi do të jenë matësi kryesor i zbatueshmërisë dhe suksesit të PSVR-së 2026-2029. Qëllimi nuk është vetëm raportimi i aktiviteteve, por garantimi që masat e planit prodhojnë rezultate të matshme dhe të dobishme për të rinjtë e bashkisë Përmet, në qytet dhe në të 4 (katër) njësitë administrative duke ruajtur fokusin në gjithëpërfshirje, akses të barabartë dhe përmirësim të vazhdueshëm të politikave rinore.

REFERENCAT:

Bashkia Përmet. (2021.). *Plani lokal i veprimit për rininë 2021–2023*, https://bashkiapermet.gov.al/wp-content/uploads/2022/04/Plan-lokal-veprimi-rinia-2021-2023_compressed.pdf

Bashkia Përmet, Këshilli Bashkiak. (2024). *Vendim për miratimin e Planit të Kujdesit Social 2024–2027* (Vendim nr. 79, 23 tetor 2024), <https://www.vendime.al>

Bashkia Përmet, Këshilli Bashkiak. (2025). *Vendim për miratimin e Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore* (Vendim i Këshillit Bashkiak, datë 01.08.2025), <https://bashkiapermet.gov.al/wp-content/uploads/2025/09/Plani-Barazise-Gjinore.pdf>

Council of Europe. (2021). *Plani kombëtar i veprimit për integrimin e romëve dhe egjiptianëve (2021–2025)* https://bashkiapermet.gov.al/wp-content/uploads/2021/02/Plani-Vendor_Permet-Per-Pakicat-Egjyptiane.pdf

Council of Europe. (2025.). *Youth sector strategy 2030*, <https://rm.coe.int/youth-sector-strategy-2030-albanian>

Council of Europe. (2025.). *Youth Strategy 2030*.<https://www.coe.int/en/web/youth/>

European Union (2018). *EU Youth Strategy 2019–2027* (Summary <https://eur-lex.europa.eu/EN/legal-content/summary/eu-youth-strategy-2019-2027>



INSTAT. (2024). *Censusi i Popullsisë dhe Banesave 2023*, <https://www.instat.gov.al>

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. (2022). *Ligji nr. 25/2022 "Për mbështetjen dhe zhvillimin e startup-eve"* (i ndryshuar me Ligjin nr. 36/2023, date. 25.05.2023). Qendra e Botimeve Zyrtare. <https://qbz.gov.al/>

Ministria e Arsimit dhe Sportit. (2021). *Strategjia Kombëtare për Arsimin 2021–2026*. Qeveria e Republikës së Shqipërisë, <https://arsimi.gov.al/arsimi-i-larte/>

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. (2021). *Agjenda kombëtare për të drejtat e femijëve 2021–2026* (Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 659, datë 3.11.2021), <https://punesociale.com/wp-content/uploads/2023/07/agjenda-kombetare-per-te-drejtat-e-femijeve>

MKEZH & Bashkia Përmet. (2025). *Pyetësori "Të Rinjtë që Sjellin Ndryshimin në Përmet"*
Pyetësor: "Të Rinjtë që Sjellin Ndryshimin në Përmet",
<https://docs.google.com/forms/d/e/1FAIpQLSdSYG2kv4hPjyebNYxGnUwxHWodOrOP1zBIWhsxJmRB>

Qeveria e Republikës së Shqipërisë; Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sportit. (2022). *Strategjia Kombëtare e Rinisë 2022–2029 dhe Plani i Veprimit* (Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 692, dt. 26.10.2022). <https://mtks.gov.al/wp-content/uploads/2025/12/Strategjia-Kombetare-e-Rinise-2022-2029>

Republika e Shqipërisë. (2015). *Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"*
<https://qbz.gov.al/>

Republika e Shqipërisë. (2019). *Ligji nr. 75/2019 "Për Rininë"*. Fletorja Zyrtare
<https://qbz.gov.al/>

<http://qbz.gov.al/eli/ligj/2019/11/04/75>

Republika e Shqipërisë. (2022). *Ligji nr. 25/2022 "Për mbështetjen dhe zhvillimin e start-up-eve"*. Fletorja Zyrtare. <https://qbz.gov.al/>

Pyetësori : "Të Rinjtë që Sjellin Ndryshimin në Përmet",
<https://forms.gle/po4TTETHP24RSD5R8>